

VENDIM
Nr. 00-2024-3759 (90), datë 29.2.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Artur Kalaja	kryesues;
Margarita Buhali	anëtare;
Sokol Ngresi	anëtar;
Vojsava Kola	anëtare;
Valbon Çekrezi	anëtar,

në seancën gjyqësore, më datë 29.2.2024, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, mori në shqyrtim çështjen civile, që i përket:

KËRKUES: Fëllëza Madhi; Bledar Madhi.

Përfaqësuar nga av. Iris Aliaj.

OBJEKTI: Lëshimin e autorizimit të tjetërsimit të pasurive nr. 283/53, 283/55, 209/16, 289/13 të të miturve bashkëpronarë Xhesika Madhi dhe Xhonsin Madhi.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut neni 6, neni 8;

Kodi i Procedurës Civile nenet 31, 32, 102;

Nenet 231-239, të kreut III, të Kodit të Familjes.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Margarita Buhali mbi parashtrimin për rregullimin e kompetencës tokësore të çështjes, pretendimet e përfaqësueses së subjekteve kërkues av. Iris Aliaj, e cila kërkoi prishjen e vendimit nr. 5063, datë 11.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe vazhdimin e gjykimit po në atë gjykatë dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes:

1. Referuar rrethanave të faktit të pranuar nga gjykatat në vendimmarrjet e tyre, ka rezultuar se, kërkuesit Thëllëza dhe Bledar Madhi kanë lidhur martesë ligjore më datë 30.11.2004. Nga martesë kanë lindur fëmijët Xhesika Madhi, e datëlindjes 18.10.2007 dhe Xhonsin Madhi, i datëlindjes 31.5.2009.

Në këtë proces ka qenë subjekt kërkues edhe shtetasja Vjollca Pasho, e cila ka lindur fëmijën Anxhelo Pasho, të datëlindjes 4.5.2012, babai i të cilit është i panjohur. Për këtë shtetase, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin e datës 10.10.2023 ka vendosur: *“Veçimin e kërtimeve në çështjen civile nr. 14728 Regj.Them., datë 18.7.2023 Regj., duke veçuar kërkesën me kërkuese Vjollca Pasho...”*.

2. Kërkueset Thëllëza Madhi dhe Vjollca Pasho janë motra. Nëna e tyre, e ndjera Ilmie Pasho, ka ndërruar jetë më datë 22.1.2022. Pas vdekjes së nënës trashëgimtarët e saj kanë kërkuar përpara noteres çeljen e dëshmisë testamentare. Me vendimin për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, me nr. 358 rep., nr. 189 kol., datë 3.2.2023, noterja ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë testamentare sipas së cilës, e ndjera Ilmie Pasho, në kohën që ka qenë gjallë ka lenë testamentin me nr. 496, datë

11.5.2016, sipas të cilit ka shprehur vullnetin e saj të lirë dhe të plotë që të gjithë pasurinë e saj t'ia lë trashëgimi djalit të saj, Dashnor Pasho, i datëlindjes 27.7.1979.

Gjatë çeljes së testamentit noterja ka evidentuar se ka cenim të rezervës ligjore sipas parashikimeve të nenit 379 të Kodit Civil.

3. Në këto kushte ajo ka konkluduar se nuk mund të përjashtohen nga trashëgimia si trashëgimtarë i paaftë për punë bashkëshorti i të ndjerës Dylber Pasho dhe nipërit dhe mbesat e mitur që trashëgojnë me zëvendësim si më poshtë vijon nga 1/10 pjesë e pronësisë: Xhesika Madhi me atësi Bledar dhe amësi Fëllëza, e datëlindjes 18.10.2007. Xhonsin Madhi me atësi Bledar dhe amësi Fëllëza, i datëlindjes 31.5.2009, Anxholina Rika, me atësi Eural dhe amësi Vjollca, e datëlindjes 27.1.2007, Anxhelo Pasho me amësi Vjollca, i datëlindjes 4.5.2012. Ky vendim është regjistruar në Agjencinë Shtetërore e Kadastrës me dokumentin me numër 02141, datë 6.2.2023 dhe konkretisht të miturit janë bashkëpronarë të katër pasurive në fshatin Goraj, Kuçovë.

4. Duke qenë se të miturit nuk mund të administrojnë pasuritë e tyre, prindërit e tyre kërkojnë nga gjykata autorizimin për tjetërsimin e pasurisë së të miturve në interesin më të lartë të tyre që lidhet me shkollimin, edukimin dhe për të pasur mundësi më të mira jetese.

5. Gjkata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 5063, datë 11.10.2023 ka disponuar:

- *"1. Deklarimin e moskompetencës tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në lidhje me kërkesën me kërkuar Fëllëza Madhi dhe Bledar Madhi me objekt: "Lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme nr. 283/53, nr. 283/55, nr. 209/16 dhe 289/13 të të miturve Xhesika Madhi dhe Xhonsin Madhi" dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.*

- *2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar".*

Në marrjen e këtij vendimi **Gjkata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka arsyetuar ndër të tjera se:** [...] Pala kërkuar ka paraqitur më datë 18.7.2023 kërkesën me objektin dhe bazën ligjore si më sipër cituar. Gjykata konstaton se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy kërkesa të veçanta, e konkretisht, atë me kërkuar Fëllëza Madhi dhe Bledar Madhi, të cilët kërkojnë lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurisë së fëmijëve të tyre të mitur Xhesika dhe Xhonsin Madhi dhe atë me kërkuar Vjollca Pasho, e cila kërkon lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurisë së fëmijës së saj të mitur Anxhelo Pasho, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrën as nga objekti as nga shkaku dhe duhet të gjykohen në dy gjykime të veçanta.

Referuar sa më sipër, me vendimin datë 10.10.2023, gjykata vendosi: *"1. Veçimin e kërtimeve në çështjen civile nr. 14728 Regj.Them., datë 18.7.2023 Regj., duke veçuar kërkesën me kërkuar Vjollca Pasho me objekt: Lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme nr. 283/53, nr. 283/55, nr. 209/16 dhe 289/13 të të miturit Anxhelo Pasho nga kërkesa me kërkuar Fëllëza Madhi dhe Bledar Madhi me objekt: Lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme nr. 283/53, nr. 283/55, nr. 209/16 dhe 289/13 të të miturve Xhesika Madhi dhe Xhonsin Madhi*

2. Urdhërohet Sekretaria Gjyqësore të fotokopjojë dhe njësojë me origjinalin të gjithë Dosjen Civile nr. 14728 Regj. Them., duke formuar: - Një dosje të re civile me numër të ri regjistrimi lidhur me kërkesën me kërkuar Fëllëza Madhi dhe Bledar Madhi me objekt Lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme nr. 283/53, nr. 283/55, nr. 209/16 dhe 289/13 të të miturve Xhesika Madhi dhe Xhonsin Madhi".

Deklarimin e moskompetencës tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në lidhje me kërkesën dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Vijimin e gjykimit për kërkesën me kërkuar Vjollca Pasho me objekt: Lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme nr. 283/53, nr. 283/55, nr. 209/16 dhe 289/13 të të miturit Anxhelo Pasho. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar".

Neni 234 i Kodit të Familjes parashikon: “Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije të mitur deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç, lënia hipotekë, ngarkimi me një barrë, marrja hua në emër të të miturit, heqja dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimi i një dhurimi, si dhe përgjithësisht veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës së vendbanimit të të miturit”. Në rastin konkret, të miturit Xhosin dhe Xhesika Madhi janë me vendbanim në Elbasan, sipas akteve të gjendjes civile, ndaj për shqyrtimin e çështjes me kërkesë Fëllëza Madhi dhe Bledar Madhi me objekt lëshimin e autorizimit për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme nr. 283/53, nr. 283/55, nr. 209/16 dhe 289/13 të të miturve Xhesika Madhi dhe Xhosin Madhi, pas veçimit, gjykata kompetente për shqyrtimin e saj, është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

7. Në këto rrethana, **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, më datë 15.11.2023, ka parashtruar qëndrimin e saj përpara Gjykatës së Lartë, duke disponuar:**

- “*Parashtrimin në Gjykatën e Lartë, të mosmarrëveshjes së kompetencës tokësore midis Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me gjykimin e çështjes me kërkesë Fëllëza Madhi dhe Bledar Madhi, me nr. 1164 (210006-01894-13-2023) regjistri themeltar, datë regjistrimi 18.10.2023.*

Në parashtrimin e qëndrimit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan argumenton se, duhet të merret në shqyrtim dhe të analizohet situata procedurale lidhur me kompetencën tokësore, duke u bazuar në parashikimet e neneve 41, 51, 61 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe nenit 138/2 të Kodit të Familjes. Referuar vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se kjo gjykatë ka vlerësuar se i mungon kompetenca tokësore për shqyrtimin e kërkesës së kërkuarve Fëllëza Madhi dhe Bledar Madhi. Referuar nenit 234 të Kodit të Familjes, rezulton se në këtë dispozitë që ka përmbajtje si materiale dhe procedurale, përcaktohet si gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesave për autorizimin në kryerjen e veprimeve juridike që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të pasurive të paluajtshme që i përkasin të miturve, gjykata ku këta të fundit kanë vendbanimin. Gjykata vlerëson se, ky parashikim ligjor duhet të interpretohet së bashku me përcaktimet e dispozitave procedurale të parashikuara në nenet 61, 45 dhe 46 të KPC-së.

Nga interpretimi sistematik dhe qëllimor i këtyre dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se kompetenca tokësore në shqyrtimin e kërkesave me objekt lëshimin e autorizimit për kryerjen e veprimeve juridike (që e tejkalojnë administrimin e zakonshëm) për pasuritë e paluajtshme që i përkasin të miturve, nuk është e natyrës ekskluzive. Bazuar në nenin 61 të KPC-së, kompetenca tokësore ekskluzive e një gjykatë i përket vetëm mosmarrëveshjeve juridiko civile të përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të KPC-së, ndërkohë që paditë që rrjedhin nga mosmarrëveshje të ndryshme nga paditë e përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të KPC-së, janë të asaj natyre për të cilat ligjvënësi e ka përcaktuar kompetencën si një aspekt procedural, për të cilin gjykata nuk mund të disponojë nëse nuk ka një kërkesë nga palët. Në referim të pikës 2 të nenit 61 të KPC-së, vlerësohet se ligjvënësi përcaktimin e kompetencës tokësore gjatë shqyrtimit gjyqësor, e ka lidhur me plotësimin e dy kushteve ligjore: Së pari, kjo kërkesë duhet të vijë nga palët; Së dyti, kjo kërkesë e palëve nuk mund të paraqitet në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor, por deri në momentin që gjykata nuk ka nxjerrë urdhrin për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Përfashtim nga ky rregull i përgjithshëm, e cila e detyron gjykatën që të ngrejë çështjen e kompetencës ligjore kryesisht, pa pasur nevojë kërkimin e shprehur të palëve dhe pa e lidhur ngritjen e saj me një fazë të caktuar të procesit gjyqësor, është vetëm rasti kur kjo kompetencë e gjykatës për të shqyrtuar një çështje gjyqësore, është e përcaktuar në mënyrë ekskluzive te nenet 45 dhe 46 të KPC-së.

Në rastin konkret, rezulton se ndodhemi në kushtet kur gjykata ka disponuar për deklarimin e moskompetencës tokësore, joekskluzive, ndërkohë që nuk është paraqitur një kërkesë nga palët. Ndodhur në këto kushte gjykata, vlerëson se deri sa palët nuk kanë paraqitur një kërkesë për deklarimin e moskompetencës dhe vetë ato kanë përcaktuar si gjykatë kompetente Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kjo e fundit vijon të jetë kompetente për shqyrtimin e kërkesës objekt gjykimi. Ndaj ndodhur në kushtet kur kompetenca tokësore për shqyrtimin e kërkesës së kërkuarve Fëllëza Madhi dhe Bledar Madhi, i përket Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bazuar në nenin 64 të KPC-së, gjykata vlerëson se duhet t'i parashtrojë këtë qëndrim Gjykatës së Lartë.

II. Procedura para Gjykatës së Lartë dhe nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore:

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”), i përbërë nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, ka marrë në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi më datë 22.12.2023. Pasi vlerësoi rrethanat e rastit në raport me vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe parashtrimin e qëndrimit lidhur me kompetencën nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, *Kolegji ka vlerësuar se në rastin konkret, shtrohet për zgjidhje çështja ligjore, nëse në gjykimet e çështjeve me karakter gracioz (pa palë kundërshtare), a mundet gjykata të konstatojë dhe vendosë kryesisht mungesën e kompetencës tokësore.*

9. Pas një hulumtimi mbi praktikën gjyqësore, kryesisht pas ndryshimeve të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile (referuar në vijim me akronimin KPC) me ligjin nr. 38/2017, Kolegji ka evidentuar se çështja e konstatimit të mungesës së kompetencës tokësore në gjykimet pa palë kundërshtare, ka qenë e diskutueshme dhe ka sjellë përjasje të ndryshme në praktikën e gjykatave më të ulëta.

10. Me ligjin nr. 38/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (në vijim referuar si ligji nr. 38/2017), KPC-ja pësoi disa ndryshime të qenësishme, duke përfshirë edhe parashikimin e sanksionuar në nenin 61, lidhur me kufizimin e konstatimit kryesisht të mungesës së kompetencës tokësore të gjykatës (aspekte të cilat do të merren në analizë, në mënyrë më të detajuar në vijim).

11. Në praktikën mbizotëruese të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku është marrë në analizë dhe interpretuar neni 61 i KPC-së, pas ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, është mbajtur qëndrimi se e drejta e gjykatës për të vlerësuar kryesisht çështjen e kompetencës tokësore është kufizuar vetëm për paditë e ngritura sipas neneve 45 dhe 46 të KPC-së dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë të zgjeruar për padi, regjimi juridik i të cilave përcaktohet në dispozita të tjera të KPC-së. Gjykata e Lartë në një sërë vendimmarrjesh dhe në mënyrë konstante, duke filluar prej vitit 2019, ka pranuar se interpretimi pajtues me parimet e përgjithshme që disiplinojnë procesin civil dhe me qëllimin e ligjëvënësit në ndryshimin e nenit 61 të KPC-së, është ai i zbatimit në mënyrë të ngushtë (*stricto sensu*) të përjashtimit të parashikuar në këtë dispozitë.

Në këtë kuptim, e drejta e gjykatës për të vlerësuar kryesisht çështjen e kompetencës tokësore ekskluzive, përfaqëson një përjashtim nga rregulli dhe nga parimi i disponibilitetit të palës dhe si e tillë nuk mund të shtrihet në mënyrë të zgjeruar edhe në raste të tjera, përveç padive të ngritura sipas neneve 45 dhe 46 të KPC-së (*shih vendimin nr. 00-2019-155, datë 28.3.2019; vendimin nr. 00-2019-265, datë 9.5.2019; vendimin nr. 00-2019-188, datë 28.3.2019; vendimin nr. 00-2019-120, datë 4.3.2019; vendimin nr. 00-2021-1005, datë 30.6.2021; vendimin nr. 00-2022-1362, datë 20.7.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*).

12. I njëjti qëndrim si më sipër, evidentohet edhe në vendimmarrjet e Kolegjit Civil lidhur me konstatimin e mungesës së kompetencës në rastin e gjykimeve pa palë kundërshtare ku përfshihen gjykimet për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok, gjykimet për caktimin e masës së përkohshme të takimit me fëmijën, vërtetimet e faktit, urdhrat e ekzekutimit etj.

Sipas një praktike vijues të mbajtur nga Kolegji rezulton se, në pikën 1 të nenit 61 të KPC-së, legjislatori ka përcaktuar si raste të kompetencës tokësore ekskluzive, ato të parashikuara në nenet 45

dhe 46 të KPC-së dhe të gjitha rastet e tjera do të konsiderohen si raste të kompetencës tokësore joekskluzive, përveç kur legjislatori do të përcaktojë shprehimisht një gjykatë si ekskluzivisht kompetente nga pikëpamja tokësore (*shih vendimin nr. 00-2022-4287, datë 14.12.2022; vendimin nr. 00-2023-2745, datë 14.6.2023; vendimin nr. 00-2020-945, datë 22.10.2020; vendimin nr. 00-2023-4542, datë 3.11.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*).

13. Krahas vendimeve të sipërcituara, pavarësisht konsistencës së vendimmarrjeve të Kolegjit Civil nga viti 2019 e vijues, janë evidentuar vendimmarrje të gjykatave më të ulëta, të cilat reflektojnë qëndrime të konstatimit kryesisht nga gjykata të mungesës së kompetencës tokësore (jo asaj ekskluzive) në gjykimet me natyrë gracioze (pa palë kundërshtare). Në thelb të këtyre qëndrimeve jurisprudenciale qëndron arsyetimi se, parashikimi i nenit 61 të KPC-së duhet të merret në konsideratë vetëm për çështjet me palë kundërshtare, ku palës së paditur i është dhënë mundësia për të kundërshtuar kompetencën tokësore dhe jo për gjykimet gracioze, në të cilat pala kundërshtare mungon dhe është gjykata ajo që mund të konstatojë dhe vendosë kryesisht për mungesën e kompetencës tokësore.

14. Kolegji ka sjellë në vëmendje se përpara Gjykatës së Lartë vijnë të paraqiten parashtrime të qëndrimeve lidhur me kompetencën, të cilat kanë si zanafillë vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta për konstatimin kryesisht të mungesës së kompetencës tokësore në gjykimet pa palë kundërshtare. Duke pasur parasysh qëndrimet e ndryshme të gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me këtë aspekt dhe problematikën ligjore në interpretimin e ligjit procedural në çështje të kësaj natyre, Kolegji Civil ka evidentuar nevojën për njësimin e praktikës gjyqësore.

15. Kolegji ka çmuar të theksojë se paqartësia e vazhdueshme e praktikës gjyqësore edhe përgjatë një periudhe të zgjatur kohore nga hyrja në fuqi e ndryshimeve të nenit 61 të KPC-së me ligjin nr. 38/2017, është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), në disa vendimmarrje të saj, ka vlerësuar uniformitetin dhe njëtrajshmërinë në zbatimin e ligjit nga gjykatat, si një nga kërkesat dhe garancitë e lidhura me procesin e rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ-së). Sipas GJEDNJ-së, vazhdimësia e vendimmarrjeve kontradiktore të gjykatave mund të krijojë një gjendje pasigurie juridike që mund të zvogëlojë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, i cili është një nga komponentët thelbësorë të një shteti të bazuar dhe udhëhequr nga parimi i sundimit të ligjit (*shih çështjen "Vinčić dhe të tjerë k. Serbisë", aplikimi nr. 44698/06, vendimi i GJEDNJ-së datë 1.12.2009*).

16. GJEDNJ-ja ka pranuar se disa divergjenca në interpretim, mund të pranohen si një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor i cili bazohet në një rrjet gjykatash (*shih çështjen "Tomić dhe të tjerë k. Malit të Zi", aplikimi nr. 18650/09, vendimi i GJEDNJ-së datë 17.4.2012*). Megjithatë, në rrethana të caktuara, vendimet kontradiktore të gjykatave, veçanërisht të gjykatave që përfaqësojnë autoritetin suprem në një sistem gjyqësor, mund të përbëjnë shkelje të kriterëve për gjykim të drejtë të parashikuar në nenin 6 të KEDNJ-së. Për këtë qëllim GJEDNJ ka evidentuar disa elementë, të cilët duhet të mbahen në konsideratë në vlerësimin e kundërshtive jurisprudenciale dhe efektin që kanë në raport me parimin e sigurisë juridike, ku përfshihen: (i) ekzistenca e zgjatur në kohë e qëndrimeve të ndryshme në praktikën gjyqësore të gjykatave; (ii) nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve jurisprudenciale; (iii) nëse këto mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe cili ka qenë efekti në praktikën gjyqësore (*shih çështjen "Şahin dhe Şahin k. Turqisë", aplikimi nr. 13279/05, vendimi i GJEDNJ-së datë 20.10.2011*).

17. Gjykata e Lartë, nëpërmjet ushtrimit të funksionit ligjor për të njësuar dhe ndryshuar praktikën gjyqësore, ka për detyrë të sigurojë një raport të ngushtë midis uniformitetit dhe konsistencës së praktikës gjyqësore dhe së drejtës së individit për një gjykim të drejtë.

18. Për sa më sipër, në çështjen ligjore të shtruar për diskutim, në referim të nenit 481 të KPC-së, Kolegji ka disponuar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë

gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, për arsye se evidentohen shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural, të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

19. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerësoi se çështja që duhet të shtrohet për njësim është: ***Në gjykimet e çështjeve me karakter gracios (pa palë kundërshtar), gjykata a mund të konstatojë dhe vendosë kryesisht mungesën e kompetencës tokësore?***

20. Kolegji planifikoi çështjen për shqyrtim, në seancë gjyqësore më datë 25.1.2024 dhe vijoi me procedurën e posaçme, të parashikuar në nenin 481 të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021. Në këto kushte, u formua trupa gjykuese prej 5 gjyqtarësh, sipas pikës 3 të kësaj dispozite dhe u procedua, mbi vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, me njoftimin individual të subjekteve të kërkuar, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, për sa i përket datës dhe orës së seancës gjyqësore, trupës gjykuese, çështjes së shtruar për njësim, duke i garantuar subjekteve të kërkuar afatin prej të paktën 15 ditësh, midis njoftimit dhe datës së seancës. Po ashtu, vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ku u pasqyrua çështja e shtruar për njësim, u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

21. Pas zhvillimit të dy seancave gjyqësore, Kolegji vendosi përfundimisht në lidhje me këtë çështje në seancën e datës 29.2.2024.

III. Vlerësimi i Kolegjit Civil

22. Në kuptimin e së drejtës procedurale civile, kompetenca është një kusht i domosdoshëm procedural, që bën të vlefshëm procesin gjyqësor, si dhe të gjitha aktet e marra në administrim gjatë zhvillimit të tij. Përcaktimi i kompetencës nënkupton identifikimin e gjykatës së cilës i takon shqyrtimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes së parashtruar në rrugë gjyqësore. Disa prej kriterëve kryesorë mbi bazën e të cilëve diferencohen llojet e kompetencës gjyqësore janë: lënda, funksioni, vlera dhe territori.

Tre kriteret e para identifikojnë kategoritë e gjykatave që kanë të drejtë të zgjidhin çështje të ndryshme në varësi të objektit të mosmarrëveshjes, funksionit që vetë ligji i ka atribuar gjykatave dhe vlerës që objekti i mosmarrëveshjes përfaqëson (*kompetenca në kuptimin vertikal*).

Kriteri i katërt përcakton se cila prej gjykatave kompetente për shkak të lëndës, ka të drejtë të gjykojë mosmarrëveshjet që lidhen me atë pjesë të territorit ku gjykata shtrihet veprimtarinë e saj (*kompetenca në kuptimin horizontal*).

23. Kompetenca tokësore e gjykatës, është e ndarë në kategori në varësi të lidhjes që ekziston midis palëve ndërgjyqëse apo midis objektit të padisë, me territorin ku vepron gjykata që ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes. Lidhja midis palës së paditur dhe territorit ku vepron gjykata, përcakton atë që njihet si *kompetenca tokësore e përgjithshme*, ndërsa lidhja midis objektit të padisë me territorin e gjykatës që ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes njihet si *kompetencë tokësore e posaçme*.

24. *Kompetenca tokësore e përgjithshme* gjen rregullim në nenet 42 dhe 43 të KPC-së. Neni 42 i KPC-së përcakton kompetencën tokësore të përgjithshme, duke pasur si kriter bazë vendbanimin ose vendqëndrimin e të paditurit person fizik. Kjo dispozitë parashikon, se: *“Paditë ngrihet në gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe kur këto nuk dihen, në gjykatën e vendit ku ai ka banesën e përkohshme. Kur i padituri nuk ka vendbanim, as vendqëndrim dhe as banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, paditë ngrihet në gjykatën ku banon paditësi”*.

Në interpretim të dispozitës rezulton se nëse ligji nuk parashikon ndryshe, është kompetente nga pikëpamja tokësore gjykata e vendit, ku pala e paditur ka vendbanimin ose vendqëndrimin e saj dhe nëse këto nuk dihen apo nuk identifikohen, gjykata e vendit ku pala ka banesën e përkohshme. Duke qenë se legjislatori nuk ka vendosur një rend zbritës midis koncepteve të vendbanimit dhe vendqëndrimit, atëherë të dy këto kriterë konsiderohen në të njëjtin nivel dhe pala paditëse ka të drejtën e zgjedhjes midis disa gjykatave kompetente, duke paraqitur padinë aty ku ajo e vlerëson.

25. Nëse pala e paditur është person juridik, atëherë gjejnë zbatim parashikimet e nenit 43 të KPC-së, sipas të cilit *“Kur i padituri është person juridik, paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku personi juridik ka qendrën e tij. Paditë që rrjedhin nga marrëdhënie juridike me një degë ose agjenci lokale të personit juridik, mund të ngrihen edhe në gjykatën ku ka qendrën dega ose agjencia, si dhe në gjykatën e shkallës së parë ku personi juridik ka një ndërtesë me aktivitet ose një përfaqësues të autorizuar që të paraqitet në gjykim për objektin e padisë”*.

Në zbatim të kësaj dispozite kompetenca tokësore e përgjithshme i përket gjykatës së vendit ku ka qendrën e tij personi juridik (vendi ku ndodhen organet drejtuese të personit juridik¹). Në varësi të faktit nëse padia rrjedh nga marrëdhënie juridike me një degë apo agjenci lokale të personit juridik, atëherë kompetenca tokësore përcaktohet nga vendi ku ka qendrën dega ose agjencia, apo nga vendi ku personi juridik ka një ndërtesë me aktivitet ose një përfaqësues të autorizuar për t'u paraqitur në gjykim.

26. *Kompetenca tokësore e posaçme* e gjykatës kompetente nga pikëpamja lëndore, përcaktohet nisur nga lidhja që ekziston midis gjykatës dhe objektit të mosmarrëveshjes së paraqitur për gjykim. Ka qenë vetë legjislatori, që për një kategori mosmarrëveshjes ka zgjedhur të përcaktojë në mënyrë të shprehur gjykatën kompetente nga pikëpamja tokësore, duke marrë për bazë aspekte specifike të mosmarrëveshjes dhe elementë të cilëve ka dashur t'i japë përparësi. Kompetenca tokësore e posaçme gjen rregullim në nenet 45-51 të KPC-së dhe në dispozita të tjera të kodit² që nuk janë të përfshira në kreun III “Kompetencat”.

Gjithashtu, parashikime të tilla lidhur me kompetencën tokësore gjejnë pasqyrim edhe në ligje të posaçme si p.sh. Kodi i Familjes³, ligji nr. 110/2016 “Për falimentin”⁴ etj.

27. Kompetenca tokësore e posaçme ndahet në dy kategori: fakultative dhe ekskluzive. Në rastet e kompetencës tokësore të posaçme fakultative ligjvënësi, jo vetëm i jep të drejtën palës paditëse të zgjedhë gjykatën kompetente nëpërmjet paraqitjes së padisë, por edhe parashikon mundësinë lidhur me ndryshimin me marrëveshje të kompetencës.

Neni 52 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se *“Kompetenca tokësore mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të palëve, përveç rasteve të parashikuara në nenet 45 e 46 të këtij Kodi dhe kur ligji e ndalon këtë marrëveshje”*. Në këtë drejtim vlen të nënvizohet se kompetenca tokësore e ndryshuar me marrëveshje me shkrim të palëve, pavarësisht vullnetit të tyre, nuk përfshihet në kategorinë e kompetencës tokësore ekskluzive. Pra, në rastin kur palët kanë caktuar me marrëveshje gjykatën kompetente nga pikëpamja tokësore dhe padia apo kërkesa paraqitet përpara një gjykate të ndryshme nga ajo e zgjedhur nga palët, kjo e fundit nuk mund të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës tokësore, pasi kjo lloj kompetence e përcaktuar me marrëveshje të palëve nuk futet në kategorinë ekskluzive sipas neneve 45 dhe 46 të Kodit të Procedurës Civile.

28. Në rastin e kompetencës tokësore të posaçme ekskluzive, legjislatori ndalon në mënyrë të shprehur mundësinë që padia të paraqitet në një gjykatë të ndryshme nga ajo e përcaktuar me ligj. Në legjislacionin procedural civil shqiptar kompetenca tokësore ekskluzive gjen rregullim në nenet 45⁵ dhe 46⁶ të KPC-së dhe kriteri që përcakton gjykatën kompetente nga pikëpamja tokësore, kushtëzohet

¹ Neni 28 i Kodit Civil përcakton se *“Personi juridik ka qendrën atje ku ndodhet organi drejtues i tij, përveç kur në statut ose në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe”*.

² Nenet 350, 375, 382, 388 të Kodit të Procedurës Civile.

³ Nenet 125, 234, 254, 263, 277 të Kodit të Familjes.

⁴ Neni 11 i ligjit nr. 110/2016.

⁵ Neni 45 i KPC-së parashikon se *“Paditë për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre. Paditë, që rrjedhin nga kallëzimi i një punimi të ri dhe i një dëmi të mundshëm, ngrihen në gjykatën e vendit ku ka ndodhur fakti për të cilin është ngritur padia”*.

⁶ Neni 46 i KPC-së parashikon se *“Paditë që rrjedhin nga trashëgimi, paditë për pavlefshmërinë e testamentit dhe ato për pjesëtimin e trashëgimit ngrihen në gjykatën e vendit ku trashëgimlënësi ka pasur banimin e tij të fundit dhe, kur ky nuk dihet, në gjykatën e vendit ku ndodhet e gjithë pasuria ose pjesa më e madhe e saj. Kur trashëgimlënësi është shtetas shqiptar dhe në kohën e vdekjes së tij nuk e ka pasur banimin në Republikën e Shqipërisë, paditë e parashikuara në paragrafin e parë mund të ngrihen në gjykatën e vendit ku trashëgimlënësi ka*

nga lidhja e ngushtë që ekziston midis objektit të padisë me një territor të caktuar. Legjislatori ka evidentuar si raste të zbatimit të kompetencës tokësore ekskluzive, paditë lidhur me të drejtat reale mbi sendet e paluajtshme, pjesëtimin e sendeve të paluajtshme të përbashkëta si dhe posedimin e tyre, të cilat ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet e paluajtshme ose pjesa më e madhe e tyre.

29. Gjithashtu, përfshihen në sferën e kompetencës tokësore ekskluzive paditë që rrjedhin nga kallëzimi i një punimi të ri dhe i një dëmi të mundshëm, të cilat ngrihen në gjykatën e vendit ku ka ndodhur fakti për të cilin është ngritur padia. Për paditë që lidhen me çështje të trashëgimisë (p.sh. padia për kërkimin e trashëgimit), paditë për pavlefshmërinë e testamentit dhe paditë për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, legjislatori ka përcaktuar si gjykatë kompetente nga pikëpamja tokësore ekskluzive gjykatën e vendbanimit të fundit të trashëgimlënësit dhe kur ky nuk dihet, kompetenca tokësore i përket gjykatës së vendit ku ndodhet e gjithë pasuria trashëgimore ose pjesa më e madhe e saj.

Në rastin e kompetencës tokësore ekskluzive ligjvënësi ka përjashtuar mundësinë që padia të mund të paraqitet në një gjykatë të ndryshme nga ajo e përcaktuar në nenet 45 dhe 46 të KPC-së, madje kjo kompetencë është e paderogueshme, pra nuk mund të ndryshohet me marrëveshje midis palëve.⁷

30. Kolegji evidenton se pas ndryshimeve të KPC-së me ligjin nr. 38/2017, koncepti i kompetencës tokësore të gjykatës në fushën civile u karakterizua nga parimi i përgjithshëm i “prorogacionit të heshtur” të kompetencës tokësore dhe kufizimit kohor të kundërshtimit të saj, me përjashtim të rasteve të kompetencës së posaçme tokësore ekskluzive.

Neni 61 i KPC-së, përpara ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017 parashikonte se “Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente”. Sipas kësaj dispozite, gjykata kishte të drejtën të konstatonte mungesën e kompetencës tokësore (krahas asaj lëndore dhe funksionale) në çdo kohë, qoftë edhe kryesisht.

31. Në vijim të ndryshimeve të KPC-së me ligjin nr. 38/2017⁸ koncepti i kompetencës tokësore nuk përbën më një prezumim procedural absolut, por është relativizuar në raport me rëndësinë që ka për vlefshmërinë e procesit gjyqësor.

Neni 61 i KPC-së, pas ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017 parashikon se, “1. Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për shkak të lëndës, funksionit ose të kompetencës tokësore ekskluzive, sipas neneve 45 dhe 46, të këtij Kodi, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente. 2. Në rastet e tjera, mungesa e kompetencës tokësore mund të merret parasysh vetëm me kërkesë të palëve, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore”. Nga përmbajtja e dispozitës konstatohet një ndryshim rrënjësor në qasjen e legjislatorit mbi rëndësinë procedurale të kompetencës tokësore, duke e kufizuar oficialitetin e gjykatës për të vlerësuar kryesisht mungesën e kompetencës tokësore joekskluzive.

32. Gjykata e Lartë në jurisprudencën e saj, duke filluar nga viti 2019, ka pranuar se çështja e kompetencës tokësore, me përjashtim të padive sipas neneve 45 dhe 46 të KPC-së, vlerësohet vetëm me kërkesë të palëve dhe për sa kohë nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

E drejta e gjykatës për të konstatuar kryesisht çështjen e kompetencës tokësore ekskluzive, duke qenë një përjashtim nga rregulli dhe nga parimi i disponibilitetit të palës, nuk mund të shtrihet në mënyrë të zgjeruar edhe në raste të tjera. Kjo do të thotë se neni 61 i KPC-së e ka kushtëzuar dhe kufizuar oficialitetin e gjykatës për të vlerësuar kryesisht kompetencën tokësore vetëm për paditë e

pasur banimin e fundit në Republikën e Shqipërisë ose në gjykatën e vendit ku ndodhet pjesa më e madhe e pasurisë së tij. Kur trashëgimlënësi nuk ka pasur në Republikën e Shqipërisë as banim të fundit, as pasuri, paditë si më sipër ngrihen në gjykatën e kryeqytetit”.

⁷ Sipas nenit 52 të KPC-së “Kompetenca tokësore mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të palëve, përveç rasteve të parashikuara në nenet 45 e 46 të këtij Kodi dhe kur ligji e ndalon këtë marrëveshje”.

⁸ Ndryshimet e KPC-së me ligjin nr. 38/2017 kanë hyrë në fuqi më datë 5 nëntor 2017, 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 98, viti 2017.

ngritura sipas neneve 45 dhe 46 të KPC-së dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë të zgjeruar (*shih vendimin nr. 00-2019-85, datë 28.2.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

33. Qëllimi (*ratio legis*) i legjislatorit i shprehur në nenin 61 të KPC-së, ka qenë shndërrimi i kompetencës tokësore në një prezumim procedural relativ dhe prapësim të kufizuar në kohë. Kolegji evidenton se një qasje e tillë e ligjvënësit e ka zanafillën që në vitin 2001, me përfshirjen në Kodin e Procedurës Civile të nenit 467/b⁹. Kjo dispozitë parashikon se “*Kur gjykata për çështjen që nuk ishte në kompetencën e saj ka dhënë një vendim të drejtë dhe, nga ana tjetër, nuk janë kapërcyer kompetencat e gjykatës së cilës i takonte çështja, gjykata e apelit ka të drejtë të mos e prishë vendimin, por të mjaftohet t’i verë në dukeje gjykatës përkatëse parregullsinë e vendimit të saj*”.

34. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, edhe përpara ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se, në lidhje me kompetencën tokësore dhe jo atë lëndore, nuk duhet anashkaluar përmbajtja e nenit 467/b të KPC-së. Me këtë dispozitë është zbutur rrjedhoja e mungesës së parakushtit procedural të kompetencës kur kjo konstatohet gjatë gjykimit në shkallë të dytë nga gjykata e apelit apo kur është kundërshtuar së bashku me vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë (*shih vendimin nr. 00-2011-72 (71), datë 17.2.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

Në kuadër të frymës së interpretimit të dispozitës rezulton se edhe përpara ndryshimeve, gjykata e apelit nuk e prishte vendimin e gjykatës së shkallës së parë kur ishin shkelur rregullat procedurale lidhur me kompetencën tokësore, për sa kohë vendimi i dhënë nga gjykata ka qenë i drejtë dhe nuk është disponuar në tejkalim të kompetencave të gjykatës së cilës i takonte çështja (gjithnjë kur gjykata ka pasur kompetencë lëndore).

35. Një gjykatë që nuk është kompetente nga pikëpamja e lëndës dhe e funksionit, nuk mund të vijojë shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje që sipas përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, është lëndë gjykimi e një gjykate tjetër apo e një shkalle tjetër gjykimi. Gjithashtu, gjykata jokompetente nga pikëpamja e lëndës dhe e funksionit nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale, pasi të gjitha veprimet dhe aktet që ajo mund të marrë janë të pavlefshme. Për këtë arsye, gjykata merr në konsideratë që në fillim të procesit gjyqësor, kryesisht apo më kërkesë të palëve, nëse ajo është apo jokompetente nga pikëpamja e lëndës dhe e funksionit për gjykimin e një mosmarrëveshjeje të caktuar.

36. Nga ana tjetër, mungesa e kompetencës tokësore të gjykatës është e korrigjueshme dhe nuk çon në pavlefshmërinë e vendimit apo nulitetin e procesit gjyqësor. Një rregullim i tillë ligjor, frymëzohet nga parimi i disponibilitetit dhe ai i konvalidimit të akteve procedurale në gjykimin civil (neni 120 i KPC-së) sipas të cilit nuk mund të shpallet pavlefshmëria e një akti procedural, pa kërkesën e palës në interes të së cilës kryhet ai akt¹⁰.

Kjo do të thotë se gjykata, që sipas ligjit nuk është fillimisht kompetente nga pikëpamja tokësore, bëhet e tillë dhe prodhon akte të vlefshme në momentin kur pala e pranon apo heshtazi ka hequr dorë nga kundërshtimi i kompetencës tokësore (*shih vendimin nr. 00-2019-63, datë 20.2.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

37. Kolegji vlerëson se parashikimi i nenit 61 të KPC-së i ndryshuar, është marrë si model nga i njëjti regjim juridik që zbatohet edhe në procesin gjyqësor administrativ. Kështu neni 13, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, parashikon se “*1. Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit. 2. Moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave [...]*”.

⁹ Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

¹⁰ Neni 120 i KPC-së (i ndryshuar me ligjin nr. 38/2017) parashikon “*Nuk mund të shpallet pavlefshmëria e një akti procedural pa kërkesën e palës, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Vetëm pala në interes të së cilës ligji parashikon një element të aktit procedural, mund të prapësojë pavlefshmërinë e aktit për mungesë të atij elementi. Prapësimi duhet të ngrihet në seancën më të parë pas njoftimit, ose menjëherë, kur dijenia merret gjatë gjykimit. Pavlefshmëria nuk mund të prapësohet nga pala që e ka shkaktuar atë dhe as nga ajo që ka hequr dorë heshtazi*”.

38. Në po të njëjtën linjë, ndryshimi i përmbajtjes së nenit 62 të KPC-së dhe shfuqizimi i nenit 63 të KPC-së, përforcon edhe më tej qëllimin e legjislatorit për ta parë kompetencën tokësore në procesin gjyqësor civil, si një prapësim procedural në kuptimin e ngushtë.

Neni 62 i KPC-së, përpara ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, sanksiononte të drejtën e ankimit të veçantë në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të gjykatës që ka shpallur moskompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes. Kjo dispozitë përpara ndryshimeve parashikonte shprehimisht se, *“Kundër vendimit të gjykatës që ka shpallur moskompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes, si dhe kundër vendimit të saj mbështetur në nenin 60 të këtij Kodi, mund të bëhet ankim i veçantë nga palët dhe nga prokurori, kur ka ngritur padi ose ka marrë pjesë në gjykimin e mosmarrëveshjes, në Gjykatën e Lartë”*.

Pas ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, neni 62 i KPC-së parashikon se *“Kundër vendimit të gjykatës mbi kompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar”*.

Ndër të tjera, me ndryshimet e vitit 2017, legjislatori shfuqizoi rregullin e sanksionuar në nenin 63 të KPC-së¹¹, sipas të cilit gjatë kohës së shqyrtimit të ankimit të veçantë kundër vendimit të kompetencës nga Gjykata e Lartë, gjykimi i çështjes pezullohej dhe gjykata mund të kryente vetëm veprime procedurale që nuk presin.

39. Kolegji thekson se qëllimi i ankimit të veçantë është krijimi i një ekuilibri të përshtatshëm për individin në një proces gjyqësor në drejtim të urgjencës, të ekonomisë gjyqësore dhe të sigurisë juridike. Çështjet për të cilat ligji lejon ankim të veçantë, janë të përcaktuara shprehimisht në legjislacionin procedural dhe mbulojnë situata urgjente, adresimi i të cilave jo vetëm dikton zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, por mundësia e gjykatës për të gabuar në këto raste duhet verifikuar aty për aty, për të shmangur dëmin nga vonesa gjer në përfundimin e shqyrtimit të çështjes. Parashikimet ligjore si më sipër, të cilat kanë shmangur zbatimin e ankimit të veçantë lidhur me vendimmarrjet sa i takon kompetencës, evidentojnë faktin se legjislatori është orientuar drejt relativizimit të natyrës urgjente të kompetencës në raport me pasojat që ky element procedural ka për vijueshmërinë e procesit gjyqësor civil.

40. Kolegji vlerëson se paragrafi i parë i nenit 61 të KPC-së do të duhet të rregullojë vetëm mënyrën se si gjykata verifikon kompetencën lëndore, funksionale dhe atë tokësore ekskluzive sipas neneve 45 dhe 46 të KPC-së. Pra, mungesa e kompetencës tokësore (joekskluzive) nuk mund të konstatohet kryesisht nga gjykata, por mund të ngrihet vetëm mbi bazën e pretendimit të palëve ndërgjyqëse. Ndryshe nga parashikimi i mëparshëm ligjor, çështjen se kush gjykatë do e zgjidhë më lehtë dhe më shpejt çështjen mund ta vlerësojnë ekskluzivisht palët dhe nuk mundet gjykata, sipas parimit të disponibilitetit të bëjë një vlerësim ndryshe të këtyre interesave. Në zbatim të nenit 61 të KPC-së edhe koha (momenti procedural) i kundërshtimit të kompetencës i nënshtrohet kufizimit, duke u sanksionuar rregullisht se prapësimi i mungesës së kompetencës tokësore mund të ngrihet dhe të merret në konsideratë nga gjykata, deri sa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore në kuptim të nenit 185/c të KPC-së.

41. Në vijim të analizës së mësipërme lidhur me kategorizimin e kompetencës tokësore (*e përgjithshme dhe e posaçme*), Kolegji çmon të evidentojë se e vetmja lloj kompetence që nuk mund të konstatohet kryesisht nga gjykata, është kompetenca tokësore, qoftë ajo e përgjithshme (*e lidhur me të paditurin*) apo e posaçme (*e lidhur me aspekte specifike të mosmarrëveshjeve të caktuara nga legjislatori*). Me përjashtim të rasteve të kompetencës tokësore ekskluzive të sanksionuar nga nenet 45 dhe 46 të KPC-së, pala apo subjekti që investon gjykatën ka të drejtën e zgjedhjes midis disa gjykatave kompetente nga pikëpamja tokësore,

¹¹ Përpara shfuqizimit me ligjin nr. 38/2017 neni 63 i KPC-së, parashikonte se: *“Me depozitimin e ankesës, sipas nenit 62 të këtij Kodi, pezullohet gjykimi i çështjes dhe gjykata mund të kryejë vetëm veprime procedurale që nuk presin. Gjykata e Lartë shqyrton ankimin në dhomë këshillimi, në kolegji, me trup gjyqësor të përbërë nga 3 gjyqtarë dhe shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se tridhjetë ditë nga momenti i depozitimit të ankesës. Gjykata e Lartë në vendimin e saj për rregullimin e kompetencës jep udhëzimet e nevojshme për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata që deklarohet kompetente”*.

të drejtë të cilën e ushtron duke paraqitur padinë në gjykatën që zgjedh. Neni 54 i KPC-së parashikon të drejtën e palës për të zgjedhur midis disa gjykatave kompetente nga pikëpamja tokësore, duke sanksionuar, se *“E drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë”*. Kjo dispozitë përcakton qartë se kompetenca tokësore për shqyrtimin e çështjes (kur kemi kompetenca alternative), konstituohet në momentin e paraqitjes së padisë apo kërkesë, para një prej gjykatave kompetente për zgjidhjen e civile.

42. Kolegji vlerëson se, ngritja e padisë përfaqëson një nga momentet më të rëndësishme të procesit gjyqësor civil, sepse nga ai moment fillojnë të lindin pasoja të ndryshme juridike për subjektet pjesëmarrës në proces. Sapo padia paraqitet në gjykatë, ajo nga një akt personal i paditësit, kthehet në një akt procedural, për shkak se të gjitha rrethanat e pasqyruara në të, do të jenë objekt i shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës.¹² KPC-ja sanksionon dhe rregullon padinë në kuptimin procedural, në ndryshim nga Kodi Civil apo ligje të tjera specifike, të cilat sanksionojnë të drejtat materiale që synohen të mbrohen nëpërmjet gjykatës, duke iu referuar kësisoj padisë në kuptim material.

Në dispozitat e tij, KPC-ja parashikon mjete të ndryshme procedurale për vënien në lëvizje të gjykatës, duke iu referuar me termat *“kërkesëpadi”* dhe *“kërkesë”*. Përdorimi i këtyre mjeteve bëhet sipas rastit dhe llojit të gjykimit për të treguar veprimin procedural me të cilin pala e interesuar, qoftë palë paditës apo subjekt kërkuar, investon gjykatën në mbrojtje të së drejtës së tij subjektive apo një interesi të ligjshëm. Në këtë drejtim të dyja këto akte kanë të njëjtin qëllim. *(shih vendimin njëses të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2023-4411 (106), datë 2.3.2023)*.

43. Në analizë të parashikimeve të KPC-së, rezulton se juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet jo vetëm mbi gjykimin e zakonshëm me palë kundërshtare, që njihet si gjykimi kontencioz (*kontradiktor, me palë kundërshtare*), por edhe mbi gjykimet të cilat vihen në lëvizje dhe zhvillohen me një subjekt kërkuar, pa pasur palë kundërshtare, të njohura si gjykimet gracioze (*ex parte, pa palë kundërshtare*). Gjykimi kontencioz ka për qëllim që të zgjidhë mosmarrëveshjet civile midis dy ose më shumë personave dhe zhvillohet gjithnjë kundrejt një pale kundërshtare, së cilës i drejtohet kërkitimi për të dhënë diçka, për të kryer ose mos kryer një veprim apo për të njohur një të drejtë. Këto gjykime investohen gjithnjë nëpërmjet aktit procedural të padisë, e cila synon: (i) rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur (neni 32/a i KPC-së); (ii) vërtetimin e qenies apo mosqenies së një marrëdhënie juridike ose të drejte (neni 32/b i KPC-së); (iii) njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së një dokumenti (neni 32/c i KPC-së).

44. Nga ana tjetër, gjykimet gracioze vihen në lëvizje gjithnjë nëpërmjet kërkesës si mjet ligjor procedural, duke mos iu kundërtuar kurrkujt, por vetëm duke dashur të arrihet një qëllim i caktuar nga vendimi i gjykatës që do ta pranojë atë. Këto gjykime nuk kanë dhe nuk mund të lejohet të kenë palë kundërshtare *(shih vendimin nr. 00-2022-4573 (406), datë 1.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë)*.

Vendimi që jep gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të një gjykimi gracioz (*pa palë kundërshtare*) ka gjithnjë karakter deklarativ dhe certifikues, duke mos prodhuar asnjëherë pasoja detyruese (*krijuese, ndryshuese apo shuese*) kundrejt një pale tjetër apo subjekti të tretë.

45. Nga një interpretim i ngushtë dhe thjesht literal i nenit 61, paragrafi i dytë i KPC-së, duket sikur mungesa e kompetencës tokësore joekskluzive, e cila mund të merret parasysht nga gjykata vetëm me kërkesë të palëve, i referohet vetëm gjykimeve me natyrë kontencioze (kontradiktore), midis palëve ndërgjyqëse me pozita procedurale të mirë-përcaktuara në rolet e paditësit dhe të paditurit. Ndërkohë, zgjedhur të përqendrohet në një interpretim qëllimor dhe sistematik të dispozitës në raport edhe me ndryshimet e sanksionuara nga legjislatori, Kolegji evidenton se kufizimi i mundësisë së gjykatës për të konstatuar kryesisht mungesën e kompetencës tokësore joekskluzive në gjykimet civile, zbatohet si në gjykimet me natyrë kontradiktore, ashtu edhe për gjykimet gracioze (pa palë kundërshtare).

¹² Stavri Çeço, *“Leksione në lëndën E drejta procedurale civile e RPSSH-së”*, Universiteti i Tiranës, “Fakultetit i Shkencave Politike Juridike”, Tiranë, 1983, f. 115.

46. Fakti që neni 61 i KPC-së nuk sanksionon një rregullim specifik për gjykimet gracioze apo krahas termit me kërkesë “të palëve” nuk përdor edhe termin “subjektive kërkesë”, nuk mund të kujtohet se i njeh të drejtën gjykatës, të verifikojë kryesisht kompetencën tokësore joekskluzive në këto lloj gjykimesh. Për sa kohë në paragrafin e parë të nenit 61 të KPC-së, legjislatori ka qenë kategorik sa u përket rasteve se kur gjykata mund të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës, duke e kufizuar atë vetëm te kategoritë e kompetencës lëndore, funksionale dhe asaj tokësore ekskluzive, kjo nënkupton se në rastet e tjera mundësia që gjykata të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës është e përjashtuar shprehimisht. E drejta e gjykatës për të vlerësuar kryesisht çështjen e kompetencës tokësore ekskluzive, duke qenë një përjashtim nga rregulli, nuk mund të shtrihet në mënyrë të zgjeruar edhe në raste të tjera krahas atyre të parashikuara shprehimisht në ligj.

47. KPC-ja udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe për pasojë gjykata, si titullare e pushtetit gjyqësor është e përgjegjshme në drejtim të zbatimit të rregullave të sanksionuara nga legjislacioni procedural civil. Në ato raste kur ligjvënësi ka pasur për qëllim të ndalojë zbatimin e një rregullimi ligjor procedural, e ka bërë këtë nëpërmjet normimit ligjor të ndalimit, bazuar në parimin e taksativitetit. Në këtë drejtim Kolegji sjell në vëmendje (*për analogji*) parashikimin e nenit 203, paragrafi i dytë i KPC-së sipas të cilit: “[...] Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij kodi”. Nenet 203 dhe 206 të KPC-së janë ndryshuar në përmbajtjen e tyre me ligjin nr. 122/2013. Në kuadër të këtyre ndryshimeve ligjore, në nenin 203 të KPC-së u shtua një paragraf, i cili ndalonte sigurimin e padisë në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij Kodi. Gjithashtu, te neni 206 i KPC-së, i cili përcakton llojet e masave të sigurimit të padisë, është hequr parashikimi i mëparshëm që gjykata mund të caktojë si masë sigurimi pezullimin e ekzekutimit.

48. Të tilla parashikime ligjore ndaluese, tregojnë se nëse legjislatori do të kishte si qëllim që të përjashtonte gjykimet gracioze (pa palë kundërshtare) nga fusha e zbatimit të kufizimit të nenit 61 të KPC-së, duke i dhënë mundësinë gjykatës për të konstatuar kryesisht mungesën e kompetencës tokësore joekskluzive në këto gjykime, do ta kishte bërë një gjë të tillë në mënyrë të shprehur. Për sa kohë nuk është sanksionuar në mënyrë taksative një përjashtim i tillë, atëherë nuk ka pse gjykatës t’i njihet një atribut i shtuar për të konstatuar kryesisht mungesën e kompetencës tokësore joekskluzive në gjykimet me natyrë gracioze.

49. Në ndryshim nga parashikimet e legjislacionit procedural civil shqiptar, në dispozitat analoge të sanksionuara në Kodin e Procedurës Civile italian (nenet 38 dhe 28 të KPC-së italian), legjislatori ka parashikuar në mënyrë të shprehur rastet e gjykimeve (përfshi ato me natyrë gracioze apo në dhomë këshillimi), në të cilat gjykata mund të konstatojë edhe kryesisht mungesën e kompetencës tokësore.

50. Neni 38 i Kodit të Procedurës Civile italian i titulluar “Moskompetenca” (*sipas ndryshimeve me ligjin nr. 69, datë 18 qershor 2009*), parashikon se, “1. Mungesa e kompetencës për shkak të lëndës, ajo për shkak të vlerës dhe ajo tokësore mund të kontestohen (pretendohet), me pasojë rënien në dekadencë, në deklaratën e mbrojtjes të depozituar në kohë. Mungesa e kompetencës tokësore konsiderohet se nuk është parashtruar (pretenduar), nëse nuk përcaktohet gjykata që pala e konsideron kompetente. 2. Përtej rasteve të parashikuara nga neni 28 i KPC-së, kur palët bien dakord për përcaktimin e gjykatës kompetente nga pikëpamja tokësore, kompetenca e gjykatës e përcaktuar nga palët mbetet e pandryshuar, nëse çështja rifillon brenda 3 muajve nga pushimi i çështjes. 3. Moskompetenca lëndore, ajo për shkak të vlerës dhe moskompetenca tokësore në rastet e parashikuara nga neni 28 i KPC-së, mund të konstatohen kryesisht nga gjykata jo më vonë se seanca e përcaktuar nga neni 183 i Kodit (seanca e parë e caktuar për paraqitjen e palëve dhe trajtimin e çështjes/seanca e parë përgatitore). 4. Çështjet e përcaktuara në paragrafët e mëparshëm vendosen, vetëm për qëllimin e kompetencës, në bazë të asaj që rezulton nga dokumentet dhe, kur shihet e nevojshme, pasi kërkohet nga pala e paditur apo konstatohet nga gjykata, merret informacion përmbledhës”. Ndërkohë nenit 28 i KPC-së italian parashikon se, “Kompetenca territoriale mund të ndryshohet me marrëveshje të palëve, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të nenit 70 (2)¹³, në rastet e ekzekutimit të detyruar,

¹³ Neni 70 (2) i KPC-së italian parashikon: “Prokurori publik duhet të marrë pjesë, me pasojë pavlefshmëri absolute të konstatuar

kundërshtimin e ekzekutimit të detyrueshëm, procesin e sigurimit dhe posedimit, proceset që zhvillohen në dhomë këshillimi dhe për çdo rast tjetër në të cilin ligji ndalon¹⁴ shprehimisht derogimin e kompetencës (ndryshimin e kompetencës)”.

51. Nga këto parashikime ligjore të legjislacionit procedural civil italian kuptohet se gjyqtari/gjykata mundet të konstatojë *ex officio* (kryesisht) rastet e moskompetencës së paderogueshme (të detyrueshme) të parashikuara në nenin 28 të KPC-së italian. Në ndryshim nga kodi ynë i procedurës civile, i cili i ka atribuuar kompetencën tokësore me natyrë ekskluzive (të paderogueshme) vetëm padive të parashikuara nga nenet 45 dhe 46 të KPC-së (lidhur me sendet e paluajtshme dhe trashëgiminë), legjislatori italian ka zgjeruar rastet e kompetencës territoriale të paderogueshme, duke përfshirë edhe mosmarrëveshjet e martesës, proceset në fazën e ekzekutimit, gjykimet në dhomë këshillimi etj.

52. Nga një interpretim krahasues midis rregullimit ligjor të sanksionuar në nenin 61 të KPC-së shqiptare, me atë të sanksionuar në nenet 38, 28 dhe 70 (2) të KPC-së italian, Kolegji identifikon se qëllim i synuar nga legjislatori është i njëjtë: *lejimi i konstatimit kryesisht nga gjykata i moskompetencës lëndore, funksionale dhe asaj tokësore ekskluzive*. Përfshirja e kategorive të ndryshme të çështjeve në fushën e kompetencës tokësore ekskluzive, mbetet atribut ekskluziv i legjislatorit dhe nuk mundet asnjë aktor tjetër i procesit gjyqësor, përfshi këtu gjykatën si garantues i mbarëvajtjes procedurale të gjykimit, t'i japë natyrën ekskluzive të kompetencës tokësore gjykimeve përtej atyre të sanksionuara shprehimisht në ligj.

53. Në këtë drejtim, legjislacioni procedural civil shqiptar ka parashikuar si raste të kompetencës tokësore ekskluzive vetëm paditë e sanksionuara nga nenet 45 dhe 46 të KPC-së, duke mos përfshirë kategori të tjera padish apo gjykimesh. Për pasojë, të gjitha rastet e tjera do të konsiderohen si raste të kompetencës tokësore joekskluzive, përveç kur legjislatori do të përcaktojë shprehimisht një gjykatë si ekskluzivisht kompetente nga pikëpamja tokësore.

54. Në KPC dhe ligje të tjera të posaçme gjejnë rregullim një sërë gjykimesh me natyrë gracioze (pa palë kundërshtare), për të cilat legjislatori ka përcaktuar gjykatën kompetente nga pikëpamja tokësore. Kështu, neni 350 i KPC-së rregullon kompetencën tokësore të gjykatës në gjykimin e kërkesave lidhur me institutin e kujdestarisë. Dispozita në fjalë parashikon se, *“Kompetent për vendosjen ose heqjen e kujdestarisë, si dhe për heqjen ose kthimin e pushtetit prindëror, është seksioni përkatës i gjykatës së shkallës së parë ku banon i mituri”*. Ndërkohë neni 263 i Kodit të Familjes parashikon se *“Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit”*. Kompetenca tokësore në rastin konkret është përcaktuar mbi bazën e lidhjes së vendbanimit të të miturit me gjykatën që mbulon atë territor dhe nuk përfaqëson një nga rastet e kompetencës tokësore ekskluzive.

55. Neni 234 i Kodit të Familjes rregullon kompetencën tokësore të gjykatës lidhur me gjykimin e kërkesave për lëshimin e autorizimit të tjetërsimit të pasurive në pronësi të të miturve. Kjo dispozitë parashikon, se: *“Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije të mitur deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç, lënia hipotekë, ngarkimi me një barrë, marrja hua në emër të të miturit, heqja dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimi i një dhurimi, si dhe përgjithësisht veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës së vendbanimit të të miturit*.

kryesisht, në proceset:

1) në çështjet që ai vetë propozon (paraqet);

2) në çështjet martesore, duke përfshirë rastet e ndarjes personale të bashkëshortëve;

3) në rastet që kanë të bëjnë me statusin dhe zotësinë për të vepruar të personave;

4) shfuqizuar me ligjin nr. 533, 11 gusht 1973;

5) në raste të tjera të parashikuara me ligj.

¹⁴ Si të tilla dispozita të cilat parashikojnë shprehimisht se kompetenca nuk mund të derogohet (ndryshohet me marrëveshje të palëve) përmenden: neni 25 (gjykimet ku është palë një organ i administratës publike); neni 413 i KPC-së (kompetenca e gjykatës lidhur me mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës); neni 661 (gjykimi për vërtetimin e dëbimit (të qiramarrësit)) etj.

Veprimi juridik, që është kryer pa u marrë autorizimi i gjykatës, mund të shpallet i pavlefshëm me kërkesën e prokurorit, të prindit ose të kujdestarit të të miturit. Në qoftë se gjykata jep pëlqimin më vonë, veprimi juridik nuk shpallet i pavlefshëm". Edhe në këtë parashikim ligjor, kompetenca tokësore është përcaktuar mbi bazën e lidhjes së vendbanimit të të miturit me gjykatën që mbulon atë territor dhe nuk përfaqëson një nga rastet e kompetencës tokësore ekskluzive.

56. Neni 254 i Kodit të Familjes rregullon kompetencën tokësore të gjykatës lidhur me gjykimin e kërkesave për birësim, duke përcaktuar se: *"Kërkesa për birësim, e bërë nga një shtetas shqiptar, bëhet në gjykatën e vendbanimit të personit që kërkon të birësojë. Kërkesa për birësim, e bërë nga një shtetas i huaj ose shqiptar që banon jashtë shtetit, paraqitet në gjykatën nën juridiksionin e së cilës ndodhet vendbanimi i të miturit. Kërkesa për birësimin e të miturit shqiptar që banon jashtë shtetit paraqitet në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë"*. Kriteri mbi bazën e të cilit është përcaktuar kompetenca tokësore në rastin e kërkesave për birësim, lidhet me vendbanimin e personit apo të miturit, i cili kërkohet të birësohet. Kjo kompetencë gjithashtu nuk përfaqëson një nga rastet e kompetencës tokësore ekskluzive.

57. Neni 375 i KPC-së rregullon kompetencën e gjykatës lidhur me gjykimin e kërkesave për shpalljen e zhdukjes apo vdekjes së personit. Kjo dispozitë përcakton se *"Kërkesa për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur mund të paraqitet nga çdo person i interesuar, nga noteri, pranë të cilit personi ka redaktuar një testament me akt noterial, apo ka depozituar për ruajtje testamentin ollograf ose testamentin e posaçëm, apo nga prokurori në gjykatën ku ka pasur vendbanimin e fundit personi për të cilin kërkohet shpallja si i tillë"*. Legjislatori në këtë dispozitë ka identifikuar si kriter për përcaktimin e kompetencës tokësore të gjykatës, vendbanimin e fundit të personit për të cilin kërkohet shpallja i zhdukur ose i vdekur, duke mos plotësuar kështu standardin e ekskluziv të kompetencës tokësore dhe duke u kategorizuar si një nga rastet e kompetencës tokësore të përgjithshme.

58. Neni 388 i KPC-së rregullon kompetencën tokësore të gjykatës lidhur me kërkesat për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik, duke përcaktuar se, *"[...] Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuesi. Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ndodhet sendi"*. Kriteret përcaktuese të kompetencës tokësore në rastin e gjykimit të kërkesës për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik, janë vendbanimi i kërkuesit ose dhe vendi ku ndodhet sendi, në rast se kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm. Lidhur me një gjykim të tillë gracioz, Kolegji Civil ka argumentuar se është një rast i zakonshëm i kompetencës tokësore dhe jo një rast i kompetencës tokësore ekskluzive dhe do të aplikohen parashikimet e pikës 2 të nenit 61 të KPC-së, për sa kohë që nuk përfshihet në parashikimet e neneve 45 dhe 46 të KPC-së *(shih vendimin nr. 00-2020-945, datë 22.10.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë)*.

59. Në rastin e kërkesës për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve, parashikuar nga neni 125 i Kodit të Familjes, jemi përpara një gjykimi pa palë kundërshtare ku bashkëshortët paraqiten si subjekte kërkues dhe investojnë gjykatën nëpërmjet aktit procedural të kërkesës. Kompetenca e gjykatave për shqyrtimin e kërkesave të tilla gjen rregullim në nenin 51 të KPC-së, i cili ka parashikuar se: *"Paditë për vërtetimin e qenies ose mosqenies së martesës, për anulimin e martesës dhe për zgjidhjen e saj, mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku bashkëshortët kanë pasur banimin e tyre të përbashkët të fundit ose në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri. Kur i padituri nuk ka banim ose vendqëndrim dhe as banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, padia ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin, vendqëndrimin ose banimin e përkohshëm paditësi dhe kur as paditësi nuk i ka ato, padia ngrihet në gjykatën e kryeqytetit"*. Në të tilla gjykime, subjektet kërkues (bashkëshortët) kanë të drejtë të disponojnë lirisht duke përzgjedhur me vullnetin e tyre gjykatën kompetente. Duke qenë se kompetenca tokësore e gjykatës për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshje nuk është ekskluzive, atëherë gjykata nuk mund të vendosë kryesisht mbi mungesën e kompetencës tokësore *(shih vendimin nr. 00-2022-4297, datë 14.12.2022)*.

60. Kolegji vlerëson se parashikimet ligjore si më sipër lidhur me kompetencën tokësore në gjykimet me natyrë gracioze, pavarësisht se janë të sanksionuar në dispozita që rregullojnë gjykime të posaçme në KPC, duhet të interpretohen jo në kundërshtim, por në raport me përcaktimin e dispozitave procedurale të përgjithshme të parashikuara në nenet 61, 45 dhe 46 të KPC-së. Bazuar në nenin 61 të KPC-së, kompetenca tokësore ekskluzive e një gjykate i përket vetëm mosmarrëveshjeve juridike civile të përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të KPC-së. Për çështjet e tjera të ndryshme nga ato të përcaktuara nga dispozitat e sipërcituara, pavarësisht nëse përfaqësojnë gjykime kontencioze (me palë kundërshtare) apo gracioze (pa palë kundërshtare), ligjvënësi e ka përcaktuar kompetencën si një aspekt procedural, për të cilin gjykata nuk mund të disponojë kryesisht.

61. Sipas një qëndrimi në vijueshmëri të mbajtur nga Kolegji edhe në raport me gjykimet me natyrë gracioze evidentohet se, në pikën 1 të nenit 61 të KPC-së legjislatori ka përcaktuar si raste të kompetencës tokësore ekskluzive, rastet e parashikuara në nenet 45 dhe 46 të KPC-së dhe të gjitha rastet e tjera do të konsiderohen si raste të kompetencës tokësore joekskluzive, përveç kur legjislatori do të përcaktojë shprehimisht një gjykatë si ekskluzivisht kompetente nga pikëpamja tokësore (*shih vendimin nr. 00-2022-4287, datë 14.12.2022; vendimin nr. 00-2023-2745, datë 14.6.2023; vendimin nr. 00-2020-945, datë 22.10.2020; vendimin nr. 00-2023-4542, datë 3.11.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*).

62. Me qëllim që një gjykatë të shqyrtojë mosmarrëveshje midis palëve (pavarësisht nga natyra e tyre) dhe të japë vendime të ekzekutueshme dhe me pasoja për to, duhet që ajo të krijohet me ligj dhe ligji të parashikojë hollësisht fushën e kompetencave tokësore dhe lëndore të saj. Shqyrtimi i një konflikti midis palëve nga një gjykatë e caktuar me ligj është element i procesit të rregullt ligjor. Termi “gjykatë” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2021; nr. 27/2013; nr. 7/2009 dhe nr. 31/2005*).

63. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, një nga elementet e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, është edhe kompetenca lëndore e gjykatës, e cila me ligj është kriter përcaktues i gjykatës që do të vendosë për çështjen dhe i procedurës gjyqësore që do të ndjekë gjykimi konkret. Në përputhje me këtë parim, ligji ka parashikuar verifikimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes me kërkesë të palëve ose me nismë të vetë gjykatës, së cilës i paraqitet kërkesëpadia, pra nëse ajo është kompetente në lëndë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur. Thelbësore në përcaktimin e kompetencës lëndore është identifikimi i natyrës së mosmarrëveshjes, konkretisht objekti dhe shkaku ligjor i saj. Këtij rregulli i nënshtrohen gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat duhet të zbatojnë përcaktimet ligjore materiale dhe procedurale për organizimin dhe funksionimin e tyre (*shih vendimin nr. 3, datë 7.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Në dallim nga vlerësimi që i bëhet kompetencës lëndore, si një nga elementët e gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata Kushtetuese nuk ka arritur një konkluzion kategorik lidhur me kompetencën tokësore. Në jurisprudencën e saj kjo gjykatë ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011 dhe nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se “[...] për sa i përket cenimit të kompetencës tokësore, nuk janë parashtruar argumente bindëse në drejtim të natyrës thelbësore të kësaj shkeljeje, ndikimit të drejtpërdrejtë që kjo shkelje ka në procesin ligjor apo cenimit në thelb të të drejtave kushtetuese (*shih vendimin nr. 35, datë 12.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Kolegji vlerëson se parashikimet e sanksionuara në dispozitat e KPC-së (nenet 282, 350, 375, 382, 388, 511 etj.) dhe ato të Kodit të Familjes (nenet 125, 234, 254, 263, 277 etj.), të cilat përcaktojnë kompetencën tokësore (jo ekskluzive) të gjykatës për shqyrtimin e çështjeve pa palë kundërshtare (*gracioze*), nuk zhbëjnë konceptin e gjykatës së caktuar me ligj, nëse palët zgjedhin të paraqesin kërkesën në një gjykatë të ndryshme nga ajo e specifikuar nga dispozita. Gjykimi i çështjeve me natyrë gracioze (pa palë kundërshtare) nga një gjykatë e ndryshme nga ajo e parashikuar nga ligji si gjykata kompetente nga pikëpamja tokësore, nuk cenon rolin e gjykatës si garantuese të aspekteve procedurale që lidhen me kompetencën. Kjo pasi kompetenca tokësore joekskluzive e gjykatës përbën një prezumim me karakter relativ të korrigjueshëm dhe është vetë KPC-ja që nëpërmjet nenit 61, i ka atribuuar subjektit kërkuar të drejtën për të përcaktuar gjykatën kompetente, sipas vlerësimit që ato i bëjnë interesave të tyre ngushtësisht personale, për gjykatën që do të zgjidhë më shpejtë dhe më lehtë çështjen e tyre.

66. Kolegji çmon të theksojë se kufizimi i prezumimit të kompetencës tokësore joekskluzive, bëhet akoma edhe me i qenësishëm në rastin e gjykimeve *camerale* (në dhomë këshillimi), të cilat zhvillohen pa praninë e subjekteve, nga gjyqtari i vetëm, mbi bazën e akteve të paraqitura (*gjykim de plano*). Në të tilla gjykime, sikundër është shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit (neni 511, KPC) apo gjykimi i masës për sigurim padie (neni 205 i KPC-së), për shkak të natyrës së posaçme, praktikisht asnjëherë nuk do të mund të vihet në diskutim nga gjykata çështja e kompetencës tokësore, për sa kohë nuk ka një palë kundërshtare që të ngrejë prapësimin e mungesës së kompetencës tokësore të gjykatës para së cilës është paraqitur kërkesa (*shih vendimin nr. 00-2019-63, datë 20.2.2019 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

67. Në kuadër të gjykimeve të tilla Kolegji sjell në vëmendje parashikimin e nenit 204 të KPC-së, i cili parashikon, se: *“Sigurimi i padisë mund të kërkohej edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia”*. Në eventualitetin që përpara ngritjes së padisë, do të paraqitej një kërkesë për sigurim padie, në një gjykatë të ndryshme nga ajo ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia, nëse pranohet parimi sipas të cilit gjykata mund të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës tokësore, atëherë në një situatë të tillë gjykata do të legjitimohej të shpallte moskompetencën për shqyrtimin e masës së sigurimit të padisë. Ndërkohë në interpretim të përmbajtjes së nenit 204 të KPC-së, për shkak të prevalencës që ka urgjenca në gjykime të këtij lloji, ligji procedural ka parashikuar një rregullim të posaçëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës kompetente.

Në analizë të kësaj dispozite në raport me nenin 61 të KPC-së, ligjvënësi legjitimon përgjithësisht çdo gjykatë me juridiksion të zakonshëm, që për shkak të karakterit emergjent që shfaqin këto lloj kërkesash t'i marrë në shqyrtim ato, pavarësisht kompetencës tokësore apo lëndore të gjykatës për shqyrtimin e padisë së ardhshme, e cila përcaktohet në momentin e paraqitjes së saj në gjykatë, sipas nenit 41/2 të KPC-së (*shih vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2021-180, datë 10.2.2021*).

68. Parimet e derogimit dhe relativizimit të rëndësisë së kompetencës tokësore joekskluzive, i përgjigjen logjikës juridike se, ndarja e gjykatave sipas kompetencës tokësore i shërben kryesisht interesave private të palëve për zhvillimin e një gjykimi efektiv, të shpejtë, në funksion të garantimit të ekonomisë gjyqësore dhe sa më pranë territorit të vendbanimit apo vendqëndrimit të tyre.

Nga ana tjetër në rastin e kompetencës tokësore ekskluzive, përcaktimi i territorit ku gjykata ushtron kompetencën e saj, lidhet me interesa të përgjithshme publike, për mbrojtjen dhe garantimin e të cilave legjislatori ka “zgjedhur” të mos kushtëzohet nga nevoja apo vullneti i palëve, duke mos i lënë atyre të drejtën të zgjedhin gjykatën. Ligjvënësi, duke sanksionuar shprehimisht kategorinë e çështjeve për të cilat zbatohen rregullimet e kompetencës tokësore ekskluzive, përcakton edhe interesat publike specifike, të cilëve u jep prioritet. Si të tilla legjislatori procedural civil shqiptar ka zgjedhur ato që lidhen me paditë për të drejtat reale mbi sendet e paluajtshme, pjesëtimin e tyre, paditë për të drejtat trashëgimore, të sanksionuara në nenet 45 dhe 46 të KPC-së. Lidhur me paditë dhe

grykimet e tjera (përfshi këtu ato me natyrë gracioze), të cilat legjislatori nuk i ka kushtëzuar me parashikimin e kompetencës tokësore ekskluzive, është pala paditëse apo subjekti kërkues që ka të drejtën të “zgjedhë” gjykatën, e cila i garanton më mirë lehtësinë e aksesit në drejtësi.

69. Ndarja e gjykatave sipas kriterit të kompetencës tokësore ka për qëllim, ndër të tjera, që palëve të mos u bëhet i vështirë aksesit në drejtësi. Për kategori të caktuara mosmarrëveshjesh, kërkohet që procesi gjyqësor të zhvillohet përpara një gjykate, vendndodhja territoriale e së cilës garanton zhvillimin e një grykimi sa më efektiv dhe brenda një afati të arsyeshëm, duke përmbyshur garancitë e procesit të rregullt ligjor (*nëni 42 i Kushtetutës, nëni 6 i KEDNJ-së, nëni 4 i KPC-së*).

Në rastin e grykimeve gracioze (pa palë kundërshtare), ku gjykata vihet në lëvizje me anë të kërkësës së subjektit të interesuar, qëllimi i kompetencës tokësore lidhur me aksesin territorial të gjykatës bie, për sa kohë ka qenë vetë pala kërkuese e cila ka përcaktuar gjykatën nëpërmjet paraqitjes së kërkësës. Në grykime të një natyre të tillë, për sa kohë mungon pala kundërshtare, nuk kemi një subjekt të cilit potencialisht mund t'i cenohet e drejta e zhvillimit të grykimit përpara një gjykate të ndryshme nga ajo ku është paraqitur kërkesa, vendndodhja territoriale e së cilës do të ndihmonte në një grykim më të shpejtë dhe efikas. Në momentin që subjekti kërkues vë në lëvizje gjykatën nëpërmjet mjetit procedural të kërkësës, pa kundërtuar pretendime drejt një pale kundërshtare, atëherë i vetmi interes për një proces efektiv që duhet mbrojtur, është ai i vetë subjektit kërkues, i cili duke paraqitur kërkesën në gjykatë ka disponuar vullnetin rreth gjykatës që kërkon të gjykojë çështjen e tij.

Ndërmarrja e iniciativës nga gjykata për konstatimin kryesisht të mungesës së kompetencës tokësore në grykimet me natyrë gracioze, do të sillte si pasojë cenimin e të vetmit interes për një grykim efektiv që ekziston në këto lloj çështjesh dhe njëkohësisht do t'i jepte dispozitave të KPC-së që rregullojnë kompetencën të njëjtën frymë që ato kishin para ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017.

70. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka pranuar se, ndryshe nga parashikimi i mëparshëm i sanksionuar nga nëni 61 i KPC-së, çështjen se kush gjykatë do e zgjidhë më lehtë dhe më shpejtë mosmarrëveshjen mund ta vlerësojnë ekskluzivisht palët dhe nuk mundet gjykata, sipas parimit të disponibilitetit, të bëjë një vlerësim ndryshe, të këtyre interesave. Përfshimisht kjo dispozitë ka parashikuar se në oficalitetin dhe disponibilitetin e gjykatës, mbetet vetëm çështja e kompetencës tokësore ekskluzive sipas neneve 45 dhe 46 të KPC-së dhe gjykata mund të investohet kryesisht për të konstatuar kompetencën tokësore vetëm për paditë reale në lidhje me sende të paluajtshme apo për paditë trashëgimore sipas këtyre dispozitave (*shih vendimin nr. 00-2020-367, datë 16.9.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

71. Kolegji çmon se parashikimi i paragrafit të dytë të nenit 61 të KPC-së, nuk mund dhe nuk duhet të merret në konsideratë vetëm për çështjet me palë kundërshtare, ku palës së paditur i është dhënë mundësia për të kundërshtuar kompetencën tokësore brenda një afati të arsyeshëm (deri sa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore). Ky parashikim ligjor është njëlloj i vlefshëm dhe i zbatueshëm edhe për grykimet gracioze, në të cilat në mungesë të palës kundërshtare, konstatimi kryesisht nga gjykata i mungesës së kompetencës tokësore nuk do t'i shërbente interesit të asnjë subjekti, pasi nuk do të vihej në diskutim asnjëherë çështja e kompetencës tokësore të gjykatës, përpara së cilës është paraqitur kërkesa që e ka vënë në lëvizje. Pala kërkuese prezumohet se e ka shprehur vullnetin se cila gjykatë do e gjykojë kërkesën në momentin që e ka paraqitur kërkesën para gjykatës respektive.

IV. Sentenca njëseuese

72. Sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, arrin në konkluzionin njëseues si më poshtë vijon:

Nëni 61 i Kodit të Procedurës Civile është i zbatueshëm edhe në çështjet pa palë kundërshtare (me karakter gracioz).

V. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

73. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se kompetenca tokësore e gjykatës që shqyrton kërkesën me objekt lëshimin e autorizimit të tjetërsimit të pasurive të të miturit (neni 234 i Kodit të Familjes) nuk përfshihet në kategorinë e kompetencës tokësore ekskluzive dhe për rrjedhojë mungesa e saj nuk mund të merret parasysh nga gjykata kryesisht, pavarësisht natyrës së gjykimit gracioz (pa palë kundërshtare).

74. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka konstatuar kryesisht se i mungon e kompetenca tokësore (joekskluzive) për shqyrtimin e kërkesës së kërkuësve, ndërkohë që subjekti kërkuar e ka përcaktuar atë si gjykatë kompetente, duke paraqitur kërkesën për investimin e gjykatës.

Në një gjykim me natyrë gracioze si ai objekt gjykimi, për shkak të natyrës së posaçme të tij, bëhet pothuajse e pamundur që të vihet në diskutim nga gjykata çështja e kompetencës tokësore. Kjo pasi nuk ka një palë kundërshtare që të ngrejë prapësimin e mungesës së kompetencës tokësore të gjykatës para së cilës është paraqitur kërkesa për lëshimin e urdhrit dhe nga ana tjetër pala kërkuuese prezumohet se e ka shprehur vullnetin se kush gjykatë do ta gjykojë kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në momentin që ka paraqitur kërkesën para Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vullnet të cilin e pohoi edhe në seancën gjyqësore në këtë gjykim, ku nëpërmjet avokates së tyre kërkuar nga kjo gjykatë *“prishjen e vendimit nr. 5063, datë 11.10.2023 dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë”*

75. Sa më sipër arsyetuar, Kolegji vlerëson se vendimi nr. 5063, datë 11.10.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me të cilin është vendosur shpallja e moskompetencës tokësore dhe dërgimi i çështjes pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është i pabazuar në ligjin procedural dhe si i tillë duhet të priset dhe çështja të dërgohet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vazhdimin e gjykimit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenet 481 e vijues, 485/2 dhe 64, të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 5063, datë 11.10.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë.

2. Ky vendim është njësuës i praktikës gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 29.2.2024

Kryesues: Artur Kalaja

Antarë: Vojsava Kola, Valbon Çekrezi

Antarë kundër: Margarita Buhali, Sokol Ngresi

MENDIM PAKICE

Për çështjen civile nr. 11249-00663-00-2023

Ne gjyqtarët, Margarita Buhali dhe Sokol Ngresi kemi votuar kundër vendimit të marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në çështjen civile me nr. 11249-00663-00-2023 që i përket:

KËRKUES: Fëllëza Madhi; Bledar Madhi.

Përfaqësuar nga av. Iris Aliaj.

OBJEKTI: Lëshimin e autorizimit të tjetërsimit të pasurive nr. 283/53, 283/55, 209/16, 289/13 të të miturve bashkëpronarë Xhesika Madhi dhe Xhonsin Madhi.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6, neni 8;

Kodi i Procedurës Civile nenet 31, 32, 102;

Nenet 231-239 të kreut III të Kodit të Familjes.

Paraqesin mendimin tonë në pakicë për këtë çështje si më poshtë.

Duke pasur parasysh çështjen e shtruar për njehsim nga kolegji civil si gjyqtarë në pakicë kemi votuar që në përgjigje të pyetjes së shtruar për diskutim përgjigja njehsuese të ishte: ***Në çështjet pa palë kundërshtare gjykata ka të drejtë të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës tokësore të saj duke i dërguar aktet në gjykatën kompetente të caktuar nga ligji.***

Ndërkohë shumica me vendimin njehsues të datës 29.2.2024 vendosi të njehsojë praktikën gjyqësore me këtë formulim njehsues, se: - **Neni 61 i Kodit të Procedurës Civile është i zbatueshëm edhe në çështjet pa palë kundërshtare (me karakter gracioz).**

I. Vlerësimi i gjyqtarëve në pakicë

Kolegji Civil (shumica) ka arritur në konkluzionin e mësipërm duke u përqendruar vetëm te paragrafit të parë të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet e drejta e gjykatës për konstatimin kryesisht të mungesës së kompetencës në rastet e kompetencës funksionale, lëndore dhe tokësore ekskluzive sipas nenit 45 e 46 të Kodit të Procedurës Civile. Ai i ka dhënë kësaj dispozite një interpretim të ngushtë duke e shtrirë zbatimin e tij edhe në çështjet me natyrë gracioze (pa palë kundërshtare) në kundërshtim me qëllimin e kësaj dispozite ligjore dhe të parimeve të interpretimit harmonik e logjik të dispozitave ligjore procedurale. Kjo mënyrë interpretimi e nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile e bërë nga shumica ka lënë pa zbatim një sërë dispozitash ligjore procedurale, që rregullojnë në mënyrë të posaçme si kompetencën tokësore të çdo çështje pa palë kundërshtare, por edhe procedurën në veçanti të gjykimit të këtyre çështjeve, gjë që vjen në kundërshtim me parimin e përgjithshëm kushtetues se *dispozitat e posaçme kanë prioritet në zbatim në raport me ato të përgjithshme*.

Si gjyqtarë në pakicë, më hollësisht paraqesim qëndrimin kundër në raport me vendimin e marrë nga shumica për sa më poshtë:

1. Kolegji Civil i përbërë me tre gjyqtarë me vendimin e ndërmjetëm të marrë më datë 22.12.2023 vendosi kalimin e çështjes për njehsim në zbatim të nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile duke mbajtur në konsideratë;

a) nevojën e zhvillimit të praktikës gjyqësore në përputhje me qëllimin e ligjit;

b) shpërndarjen e çështjeve pa palë kundërshtare në gjykatat kompetente nga pikëpamja tokësore në respektim të mënyrës së organizimit të rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm dhe të rritjes së eficiencës së gjykimit të tyre në raport me gjendjen aktuale të tyre të stokut dhe të vonesës në pritje të krijuara në gjykim pas ndryshimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile nga ligji nr. 38/2017;

c) eliminimin e qëndrimeve të ndryshme të praktikës gjyqësore lidhur me interpretimin e nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile në çështjet pa palë kundërshtare, ku gjykatat e shkallës së parë në mënyrë të vazhdueshme kanë verifikuar e konstatuar kryesisht kompetencën tokësore në respektim të parimit se gjykata e caktuar me ligj përbën garancinë primare të respektimit të një procesi të rregullt ligjor. Në

këto çështje, ku mungon pala -subjekt procedural mbajtëse e së drejtës së kundërshtimit të kompetencës tokësore në kuptim të nenit 61/2 të Kodit të Procedurës Civile garanti i procesit të rregullt ligjor është vetë gjykata, rol që ajo është e detyruar ta ushtrojë në respektim të parimit kushtetues të paraparë nga neni 42 i Kushtetutës.

2. Konstatimi i shumicës në vendim njëhësues të datës 29.2.2024 për qëndrueshmërinë e interpretimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile në raste të ngjashme, së pari jo vetëm që nuk është i saktë, por as nuk mund të përbëjë një shkak për të konsoliduar me njëhës një praktikë që bie ndesh dhe e deformon qëllimin e kuptimit të ligjit. Në kuadër të verifikimit të historikut të qëndrimeve të Gjykatës së Lartë konstatohet se ndryshimet e ligjit nr. 38/2017 në nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile për kufizim të rolit aktiv të gjykatës në çështjet e kompetencës tokësore, nuk prekën praktikën e mëparshme gjyqësore pasi pothuajse gjatë gjithë vitit 2018 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se çështjet pa palë kundërshtare si ato të urdhrave të ekzekutimit etj. nuk binin nën fushën e zbatimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile për shkak të natyrës së veçantë të këtyre çështjeve dhe gjykata ruante të drejtë të konstatonte kryesisht mungesën e kompetencës tokësore. Ndryshimet në praktikën e Gjykatës së Lartë në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur më parë filluan të ndodhin në vitin 2019, kur gjykata e lartë pothuajse ishte suprimuar për shkak të efekteve të procesit të vetingut ndaj gjyqtarëve.

3. Duke mbajtur në konsideratë qëndrimet e kundërta në praktikën gjyqësore dhe për më tepër problematikën e sjellë nga zbatimi i nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile pas ndryshimit nga ligji nr. 38/2017 në shpërndarjen disproporcionale të ngarkesës së punës së gjykatave në kundërshtim me organizimin e rretheve gjyqësore, cenimin e dukshëm të eficiencës së gjykimit për çështjen e kësaj natyre, si gjyqtarë në pakicë evidentojmë se mënyra e interpretimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile nga shumica jo vetëm nuk i përshtatet frymës së ligjit, por nxit rritjen e vonësave në gjykim të kësaj kategorie çështjesh në kundërshtim me parimin “eficiencë gjykimi” me të cilën shumica argumenton konkluzionin e saj se neni 61 i Kodit të Procedurës Civile zbatohet në të njëjtën mënyrë si për çështjet me palë kundërshtare dhe për çështjet pa palë kundërshtare. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni pakica ka në konsideratë edhe faktin se shqyrtimi kryesisht nga gjykata i kompetencës tokësore për çështjet me natyrë gracioze i shërben jo vetëm interpretimit të drejtë të ligjit, por edhe ndarjes sa më të barabartë të ngarkesës së këtyre çështjeve midis gjykatave sipas hartës gjyqësore, e cila ishte organizuar duke mbajtur në vëmendje pikërisht rregullat e kompetencës tokësore të përcaktuara për këtë natyrë çështjesh në Kodin e Procedurës Civile. Mënyra e interpretimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile nga shumica sipas së cilës kompetenca tokësore me përjashtim të asaj ekskluzive të nenit 45 e 46 të K.Pr.C. mund të ngrihet vetëm nga palët deformon qëllimin e ligjit për çështjet pa palë kundërshtare dhe ndikon negativisht në organizimin e ndarjes e ngarkesës së punës midis gjykatave në kundërshtim me parimin e eficiencës së gjykimit.

4. Kompetenca tokësore e gjykatave përbën një kriter të rëndësishëm dhe bazë për ndarjen e organizimin e hartës gjyqësore në përputhje me ligjin nr. 98/2016. Kështu në nenin 13 të ligjit nr. 98/2016 parashikohet, se: *Këshilli i Lartë Gjyqësor bën vlerësimin e organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo pesë vjet. 2. Në rast se nga vlerësimi rezulton se harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbush objektivat, parimet dhe kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministri i Drejtësisë hartojnë një propozim të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave. Në nenin 14, parashikohet, se: Kompetencat tokësore caktohen duke synuar përmbushjen në mënyrë të ekuilibruar të objektivave të mëposhtëm: a) garantimin e aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën; b) uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektivitet të burimeve publike; c) rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara. Po në vazhdim në nenin 15 të ligjit parashikohet, se: 3. Rrethet gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave caktohen duke marrë parasysh, në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme, kriteret e mëposhtme: a) ndarjen administrative territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e*

banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike; b) ngarkesën në gjykata, në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, eficiencën e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, burimet njerëzore në dispozicion, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

5. Duke iu referuar këtyre dispozitave del e qartë se rregullat për përcaktimin e kompetencës tokësore të gjykatave sipas Kodit të Procedurës Civile i shërbejnë jo vetëm krijimit të lehtësirave të aksesit në drejtësi të qytetarëve, por dhe një ndarje sa më barabartë të punës midis gjykatave në përputhje me ndarjet administrative e zhvillimin demografik, burimeve njerëzore në dispozicion në gjykata, eficiencës së gjykatave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut etj. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 70, datë 27.12.2023 lidhur me hartën gjyqësore theksoi, se: Gjykata vëren se objektivat e përcaktuar nga ligjvënësi në ligjin nr. 98/2016 për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave janë garantimi i aksesit në drejtësi, ulja e kostove, si dhe rritja e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimit. Ligji ka ngarkuar KLGJ-në si organin përgjegjës për vlerësimin e situatës aktuale, rivlerësim që kryhet çdo pesë vjet dhe ky organ propozon edhe rishtikimin e organizimit gjyqësor nëse është i nevojshëm, pra nëse ai nuk respekton objektivat dhe parimet e përcaktuar nga ligjvënësi. Bazuar në këto parashikime ligjore, organet kompetente sipas këtij ligji kanë synuar që përmes hartës së re gjyqësore të zgjidhin problematikat e evidentuara në situatën aktuale në vendin tonë... Referuar provave të paraqitura nga palët në gjykim dhe parashkrimeve të subjekteve të interesuara, organizimi i ri gjyqësor (krijimi i një gjykate apeli) rezulton të jetë mjeti me të cilin mund të arrihet përmbushja e kërkesës për eficiencë dhe efikasitet të sistemit të drejtësisë.

6. Në analizë sa më sipër del se çështja e kompetencës tokësore të gjykatave nuk afekton vetëm subjektet procedurale konkrete pjesëmarrës në një mosmarrëveshje, por të gjithë popullatën, si dhe ndikon në mënyrën e organizimit dhe ndarjen e rrethëve gjyqësore duke imponuar ndryshimet e shpeshta të tyre. Kjo situatë nuk i shërben rritjes së eficiencës së gjykimit për individët dhe dëmton nivelin e shërbimeve gjyqësore që ofrohen në gjykata, pasi disa gjykata mund të rëndohen me një numër shumë më të lartë çështjesh megjithëse nuk janë kompetente nga pikëpamja tokësore, ndërkohë që numri i gjyqtarëve në këto gjykata është i kufizuar në përputhje me pritshmërinë e ngarkesës së planifikuar paraprakisht sipas kriterëve ligjore të kompetencës tokësore të gjykatave në ndarjen e çështjeve. Pra mënyra e ngushtë e interpretimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile nga shumica në vendimin njehsues të datës 29.2.2024 në fakt jo vetëm që nuk i ka hapur rrugë gjykimit sa më të shpejtë e efektiv të çështjeve pa palë kundërshtare nga gjykata e caktuar me ligj, por ka ndikuar në një shpërndarje të pabarabartë të çështjeve të kësaj kategorie megjithëse burimet njerëzore në gjykata për zgjidhjen e tyre janë llogaritur sipas zbatimit korrekt të kriterëve ligjore të kompetencës tokësore për këto çështje.

7. Sigurisht kufizimi i rolit aktiv të gjykatës për konstatimin e kompetencës tokësore sipas neni 61 të Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar nga ligji nr. 38/2017 ka ndikuar edhe në shpërndarjen e çështjeve me palë kundërshtare, por lidhur me këto të fundit parashikimi ligjor kufizues është qartësisht i shprehur, ndërkohë që nuk ka një parashikim të tillë për çështjet pa palë kundërshtare. Gjykata e Lartë ka për detyrë të interpretojë ligjin në mënyrë harmonike për të zbuluar qëllimin e tij në zbatim të rritjes së eficiencës në drejtësi. Kjo e fundit nuk arrihet me mundësinë e publikut për paraqitjen e çështjes pa palë kundërshtare në çdo gjykatë, sikurse arsyeton shumica, por me marrjen e shërbimit të gjykimit të çështjes në kohë sa më të shpejtë e me cilësi nga gjykata. Duke mbajtur në konsideratë këtë parim kushtetues dhe përmbajtjen e tërësisë së nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile në krahasim me të gjitha dispozitat e posaçme të kompetencës tokësore për çështjet me natyrë gracioze, si gjyqtarë në pakicë vlerësojmë se kriteri ndalues i rolit aktiv të gjykatës për konstatimin kryesisht të kompetencës tokësore (të ndryshme nga ajo ekskluzive) i parashikuar nga neni 61/1 i Kodit të Procedurës Civile nuk gjen zbatim për gjykimet pa palë kundërshtare. Për këto çështje gjykata ka kompetencë të verifikojë në çdo rast kompetencën e saj tokësore si garante e respektimit të procesit të rregullt ligjor.

8. Për të kuptuar fushën e zbatimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën tokësore është e nevojshme të interpretohet kjo dispozitë duke mbajtur në konsideratë metodat e interpretimit të ligjit si në kontekstin historik, sistematik, teologjik, harmonik. Vetëm në këtë mënyrë mund të identifikohet qëllimi i kësaj dispozite dhe risia, që ka dashur ligjvënësi të sjellë nëpërmjet ndryshimit të saj me ligjin nr. 38/2017 në kufizimin e rolit aktiv të gjykatës për konstatimin kryesisht të kompetencës tokësore të gjykatës.

9. Në lidhje me historikun e legjislacionit për kompetencën tokësore të gjykatës, ligji procedural civil i ka njohur gjithmonë të drejtë gjykatës të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës së saj dhe ta dërgojë çështjen te gjykata kompetente. Për herë të parë kufizimi i së drejtës së gjykatës për konstatimin kryesisht të moskompetencës tokësore të saj për gjykimin e çështjeve ndodhi me ligjin nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili në nenin 13 të tij parashikoi se: 1. *Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit.* 2. *Moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave.* Ky parashikim është pjesë e procedurës së gjykimit të çështjeve administrative dhe mënyra e zbatimit të saj mund të kuptohet nga interpretimi në tërësi me dispozitat e tjera, që rregullojnë procedurën e gjykimit administrative. Konkretisht fusha e zbatimit të kësaj dispozite është e lidhur ngushtësisht me llojin e çështjeve, që gjykohen në procesin administrative. Sipas nenit 7 dhe nenit 17 të ligjit nr. 49/2012 në kompetencën lëndore të gjykatave administrative hyjnë shqyrtimi i padive që kanë lidhje me mosmarrëveshjeve nga aktet administrativ, veprimet e mosveprimet e organeve administrative, kontratat administrative, marrëdhëniet e punës së një kategorie punonjësish që rregullohen me ligj të posaçëm, kundërvajtjen administrative etj. Pra në gjykimin administrative, natyra e çështjeve objekt shqyrtimi në lëndë të saj është ajo me palë kundërshtare. Për rrjedhojë neni 13 i ligjit nr. 49/2012 rregullon mënyrën e konstatimit të moskompetencës tokësore pikërisht në çështjet me palë kundërshtare. Në gjykimin administrative, në ndryshim nga gjykimi civil nuk ka gjykime me karakter jokontencioz ose pa palë kundërshtare.

10. Neni 61 I Kodit të Procedurës Civile I ndryshuar me ligjin nr. 38/2017 parashikon, se: 1. *Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për shkak të lëndës, funksionit ose të kompetencës tokësore ekskluzive, sipas neneve 45 dhe 46, të këtij Kodi, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.* 2. *Në rastet e tjera, mungesa e kompetencës tokësore mund të merret parasysh vetëm me kërkesë të palëve, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.* Duke i krahasuar këtë dispozitë me nenin 13 të ligjit nr. 49/2012 del se të dyja këto nene kanë të njëjtin formulim për rregullin që kompetenca tokësore merret në konsideratë nga gjykata me kërkesë të palëve. Përderisa ky formulim është përfshirë në Kodin e Procedurës Civile sipas shembullit, që ka pasur në ligjin procedural nr. 49/2012 të gjykimit administrativ atëherë edhe mënyra e kushtet e zbatimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile kanë të njëjtën qasje për llojin e çështjeve, ku aplikohet, që janë pikërisht çështjet me palë kundërshtare.

11. Interpretimi i një kriteri ose instituti i së drejtës të marrë nga një ligj tjetër bëhet duke mbajtur në konsideratë kuptimin ligjor e jurisprudencial, që i është dhënë këtij instituti në atë ligj, pasi institutet e njëjta të së drejtës nuk mund të kenë kuptime të ndryshme pavarësisht ligjeve, ku ato përfshihen. Edhe në manualin e hartimeve të ligjeve f. 106 përcaktohet se *Hartuesi duhet të shikojë të gjithë legjislacionin ekzistues të fushës përkatëse para se të fillojë punën hartuese në mënyrë që të sigurojë përdorimin konsistent të terminologjisë.* Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohen gjykime me natyrë gracioze, pra pa palë kundërshtare. Nën këtë logjikë edhe parashikimi i nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile, që lejon marrjen në shqyrtim nga gjykata të rasteve të tjera të kompetencës tokësore vetëm me kërkesën e palëve, sikurse neni 13 i ligjit nr. 49/2012, ka të bëjë me gjykimet me palë kundërshtare.

12. Një konkluzion i tillë rrjedh edhe nga interpretimi gramatikor e logjik i nenit 61 të K.Pr.Civile. Më konkretisht në paragrafin e parë të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile citohet rregulli bazë i

përgjithshëm i konstatimit të moskompetencës që ka të bëjë me kompetencën funksionale, lëndore dhe atë tokësore ekskluzive. Në bazë të këtij rregulli gjykata konstaton moskompetencën e sipërcituar kryesisht ose me kërkesë të palëve. Duke qenë se për këto lloje kompetencash gjykata e ka të drejtën e konstatimit kryesisht të moskompetencës atëherë del e nevojshme të interpretohet kjo dispozitë në tërësi për të kuptuar se kur kufizohet roli aktiv i gjykatës. Ky kufizim gjen shprehje në paragrafin e dytë të nenit 61 të K.Pr.Civile. Sipas kësaj dispozite në raste të tjera të kompetencës tokësore, mungesa e kompetencës merret parasysh kur ekzistojnë dy kushte kumulative; a) me kërkesë të palëve; b) të ngritur deri sa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore. Atëherë lind pyetja nëse ky paragraf I dytë përbën përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i nenit 61/1 të Kodit të Procedurës Civile dhe nëse neni 61/1 i K.Pr.Civile ndalon ngritjen kryesisht të kompetencës tokësore nga gjykata në çështjet pa palë kundërshtare?

13. Shumica e ka interpretuar nenin 61/2 të Kodit të Procedurës Civile si një përjashtim nga rregulli bazë i nenit 61/1 i K.Pr.Civile, rregull që sipas saj vlen edhe për gjykimet pa palë kundërshtare. Shumica gabon në nxjerrjen e një konkluzioni të tillë. Për të përcaktuar kuptimin e nenit 61 të Kodit të Procedurës civile gjykata është e detyruar të ndjekë disa metoda të interpretimit të ligjit, duke filluar nga konteksti historik, sistematik, teologjik, gramatikor, dinamiko-evolucionare etj., të cilat nuk rezultojnë të jenë analizuar në vendimin njëhjesues nga shumica.

14. Metoda gramatikore përgjithësisht përdoret për një term të caktuar, ndërsa kur është fjala për një rregull atëherë kuptimi dhe mënyra e zbatimit të tij del zakonisht nga metodat e tjera të interpretimit. Në rastin konkret është i nevojshëm qartësia e kuptimi i rregullit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit gjykata me kërkesë të palëve ose kryesisht konstaton çështje të kompetencës funksionale, lëndore ose të kompetencës tokësore ekskluzive.

15. Në lidhje me kompetencën tokësore rregulli i nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile është që gjykata kryesisht ose me kërkesë të palëve konstaton mungesën e kompetencës tokësore ekskluzive. Ndërsa në paragrafin e dytë të nenit 61 parashikohet se në rastet e tjera të kompetencës tokësore, mungesa e kompetencës tokësore të gjykatës konstatohet me kërkesë të palëve të paraqitur para nxjerrjes së urdhrit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Duke i krahasuar të dy këta paragrafë del se përcaktimi i paragrafit të dytë në lidhje me kompetencën tokësore, megjithëse është vendosur më pas nuk përbën përjashtim, por është rregulli bazë i mënyrës së konstatimit të kompetencës tokësore. Kjo del nga interpretimin unik i gjithë dispozitës. Sipas këtij interpretimi moskompetenca tokësore konstatohet si rregull me kërkesë të palëve të paraqitur para kalimit të çështjes në seancë gjyqësore me përjashtim të kompetencës ekskluzive tokësore që mund të konstatohet edhe kryesisht nga gjykata. Vetëm nga interpretimi unik i gjithë nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile kuptohet cili është rregulli bazë i mënyrës së konstatimit të kompetencës tokësore. Kështu e drejta e palëve për ngritjen e pretendimeve për kompetencën tokësore gjendet si në nenin 61/1 dhe 61/2 të Kodit të Procedurës Civile, duke mbetur vetëm një mundësi përjashtuese nga ky rregull që është konstatimi kryesisht nga gjykata i kompetencës tokësore ekskluzive.

16. Nisur nga sa më sipër del se rregulli i përgjithshëm është se moskompetenca tokësore ngrihet nga palët para nxjerrjes së urdhrit për kalimin në seancë gjyqësore. Atëherë diskutimi është nëse ky rregull i përgjithshëm përfshin apo jo edhe çështjet pa palë kundërshtare apo është i zbatueshëm vetëm për gjykimet me palë kundërshtare? Për të kuptuar natyrën e çështjeve, ku gjen zbatim ky rregull atëherë në radhë të parë përdorim metodën e interpretimit gramatikor të termave të përmbajtura në dispozitë. Në bazë të kësaj metode janë dy element, që kushtëzojnë zbatimin e këtij rregulli konkretisht a-subjekti -ushtrimi i kërkesës së moskompetencës nga “palët” dhe b- koha-para nxjerrjes së urdhrit për kalim në seancë gjyqësore. Të dyja këto kushte duhet të ekzistojnë njëkohësisht për të bërë të mundur marrjen në shqyrtim të moskompetencës tokësore nga gjykata.

17. Termi 'palë' i pasqyruar në nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile nuk identifikon automatikisht se të drejtën e kundërshtimit të kompetencës tokësore të gjykatës e ka çdo lloj pale pjesëmarrëse në procesin civil, pra si paditësi, i padituri, kërkuesi, personat e interesuar ose prokurori. Qëllimi i kufizimit të rolit aktiv të gjykatës për të konstatuar kryesisht moskompetencën tokësore të saj është bërë për t'i dhënë mundësi realizimit të aksesit në drejtësi nga palët para çdo gjykate, me kusht, që kjo e fundit të ishte kompetente nga pikëpamja lëndore e funksionale. Pala paditëse ose ajo që vë në lëvizje gjykatën e ushtron të drejtën e saj të zgjedhjes së gjykatës kompetente deri në momentin e ngritjes së padisë, kjo në zbatim të nenit 54 të Kodit të Procedurës Civile. Me paraqitjen e padisë pala paditëse konsiderohet se e ka ushtruar të drejtën e saj ligjore për përcaktimin e gjykatës kompetente dhe ajo nuk ka të drejtë ta revokojë ose ta ndryshojë më vonë këtë vullnet të shfaqur prej saj. Në rast se do të pranohej e kundërta atëherë rregulli se paditësi zgjedh gjykatën kompetente me paraqitjen e padisë do të ishte i pazbatueshëm.

18. Paraqitja e padisë si një akt i zgjedhjes së gjykatës është një veprim procedural, i cili nuk mund të revokohet më pas nga paditësi me përjashtim të rastit kur pala paditëse heq dorë nga gjykimi i çështjes ose nuk paraqitet në gjykim, gjë që në fakt do i jepte fund shqyrtimit të çështjes pa vendim përfundimtar dhe paditësi më pas do të rifitonte të drejtën që nëpërmjet riparaqitjes së padisë të zgjidhte një gjykatë tjetër për shqyrtimin e çështjes. Për rrjedhojë kjo palë, pra pala paditëse (në çështjet me palë kundërshtare) ose kërkuese (në çështjet pa palë) nuk mund të pretendojë në një moment të mëvonshëm mungesën e kompetencës së gjykatës të zgjedhur prej saj në kuptim të nenit 61/2 të Kodit të Procedurës Civile. E vetmja mundësi e paditësit për të ndryshuar gjykatën kompetente të zgjedhur është që të pushojë gjykimin e çështjes së filluar dhe ta ringrejë atë më vonë para një gjykate tjetër.

19. Duke qenë se paditësi është pala, që e shfaq vullnetin e saj për përcaktimin e gjykatës kompetente me paraqitjen e padisë dhe nuk mund ta revokojë ose ta ndryshojë këtë "zgjedhje" gjatë gjykimin, atëherë të drejtën për të ngritur pretendime për moskompetencën e gjykatës sipas nenit 61/2 të Kodit të Procedurës Civile e ka pala tjetër kundërshtare, pra pala që nuk ka qenë në dijeni të procesit derisa iu njoftua padia. Sipas vendimit unifikues nr. 5/2012 përcaktohet, se: *Është paditësi ai që me padinë e tij tregon dhe jep lëndën mbi të cilën gjykata ushtron të drejtat dhe detyrat e ngarkuara nga ligji në dhënie të drejtësisë, por procesi gjyqësor zhvillohet në respektim të parimit të kontradiktorialitetit. Në respektim të këtij parimi dhe të neneve 3, 12, 18, 20, 31 dhe 32 të Kodit të Procedurës Civile edhe pala tjetër e thirrur në gjykim ka të drejtat dhe detyrimet e saj në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.* Në rezime kjo është pala që në kuptim të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile ka të drejtë të kundërshtojë kompetencën tokësore të gjykatës së zgjedhur nga pala që e inicioi gjykatën për shqyrtimin e mosmarrëveshjes. Një rregull i tillë është paraparë nga ligji për t'u vendosur në një pozitë të barabartë të dyja palët pjesëmarrëse në një gjykim në mënyrë që ato të kenë mundësi të ushtrojnë të drejtat e tyre për të kërkuar gjykimin e çështjes nga një gjykatë kompetente e përcaktuar nga ligji sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të drejtave të njeriut.

20. Neni 61 i Kodit të Procedurës Civile i ndryshuar me ligjin nr. 38/2017 vendosi një rregull të ri për përcaktimin e gjykatës kompetente tokësore për shqyrtimin e çështjes, që ishte zgjedhja e gjykatës me paraqitjen e padisë, pavarësisht nga fakti nëse kjo gjykatë ishte apo jo ligjërisht kompetente nga pikëpamja tokësore për gjykimin e çështjes. Megjithatë zgjedhja e një gjykate jokompetente nga paditësi nuk shuan dhe as përjashton zbatimin e rregullave ligjore për kompetencën tokësore të gjykatës për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast garanti i kontrollit të respektimit të ligjshmërisë për kompetencën tokësore të gjykatës është i padituri, si pala që ka të drejtë të ngrejë pretendime për moskompetencën e gjykatës deri para nxjerrjes së urdhrit për kalimin e çështjes në seancë. Pra, gjykata e zgjedhur nga paditësi me paraqitjen e padisë fiton cilësinë e gjykatës kompetente për gjykimin e çështjes sipas nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile vetëm në sajë të vullnetit, të shprehur ose me heshtje, të të paditurit për ta pranuar atë si gjykatë e shqyrtimit të çështjes.

21. Për rrjedhojë gjykata e zgjedhur nga paditësi, megjithëse gëzon pritshmëri për të fituar kompetencë në gjykimin e çështjes, nuk konsiderohet përfundimisht gjykatë kompetente me ligj për shqyrtim për aq kohë sa pala kundërshtare ende nuk është njoftuar për gjykimin dhe ende nuk është nxjerrë urdhri i kalimit në seancë gjyqësore. Në fazën procedurale nga momenti i paraqitjes së padisë deri në momentin e nxjerrjes urdhrit për kalimin në seancë gjyqësore çështja e kompetencës tokësore të gjykatës të zgjedhur nga paditësi për gjykimin e çështjes është ende e diskutueshme. E drejta e zgjedhjes së paditësit të gjykatës kompetente do të konsiderohej përfundimtare vetëm në rastet, kur ai zgjedh njërën prej gjykatave, që konsiderohen kompetente ligjërisht për gjykimin e çështjes. Nëse ai paraqet padinë në një gjykatë jokompetente, kjo e fundit do të fitojë kompetencë për gjykimin e çështjes, kur pala tjetër e pranon ose nuk e kundërshton kompetencën tokësore të saj brenda afatit ligjor.

22. Kushti i dytë i diskutimit të kompetencës është momenti kohor deri kur mund të ushtrohen pretendimet për moskompetencë, i cili është i kufizuar me pasojë dekadence deri para se të nxirret urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Pra, del se kompetenca tokësore me përjashtim të asaj ekskluzive mund të merret parasysh nga gjykata me kërkesë të palës kundërshtare të ngritur deri para se jetë dhënë vendimi për kalimin në seancë gjyqësore. Duke mbajtur në konsideratë këto dy kushte që bëjnë të zbatueshme rregullin e përgjithshëm të shqyrtimit të kompetencës tokësore nga gjykata kuptohet se gjykata e shqyrton moskompetencën tokësore të saj në gjykimin e atyre çështjeve, ku ngrihet një pretendim i tillë nga pala kundërshtare derisa nuk është dhënë vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Për rrjedhojë në çështjet pa palë kundërshtare ky rregull i përgjithshëm është i pazbatueshëm, pasi nuk ka asnjë palë kundërshtare në këto lloj gjykimesh, pra mungon subjekti të cilit ligjërisht i është njohur e drejta për të ngritur pretendimet e moskompetencës tokësore të gjykatës.

23. Mënyra e formulimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile është bërë me qëllim që çështja e kompetencës tokësore të gjykatës të ketë mundësi të diskutohet, pavarësisht se një e drejtë e tillë i është lënë në iniciativë palës kundërshtare. Mungesa e palës kundërshtare do të bënte të pamundur verifikimin e shqyrtimin e ligjshmërisë së kompetencës tokësore të gjykatës së zgjedhur nga kërkuesi, gjë që bie në kundërshtim me qëllimin e kësaj dispozite në veçanti dhe të të gjitha dispozitave të tjera që rregullojnë kompetencën tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjeve pa palë kundërshtare. Të gjitha dispozitat ligjore për përcaktimin e kompetencës tokësore të gjykatës në çështjet pa palë kundërshtare do të mbeteshin të pazbatueshme, pasi kompetenca e gjykatës do të përcaktohej vetëm nga zgjedhja e kërkuesit me paraqitjen e kërkesës. Një gjë e tillë do të binte ndesh me parimin e ligjshmërisë. ku dispozitat ligjore janë parashikuar me qëllim zbatimin e tyre dhe jo për të qenë të paefektshme.

24. Për më tepër në gjykimin pa palë kundërshtare, e drejta e kërkuesit për të zgjedhur gjykatën kompetente nëpërmjet paraqitjes së kërkesës nuk mund të gëzojë më shumë privilegje ligjore se sa në gjykimin e çështjeve me palë kundërshtare. Përkundrazi roli i gjykatës në gjykimin e çështjeve gracioze është më aktiv se në çështjet me palë kundërshtare. Në këto të fundit mbizotëron vullneti i palëve dhe veprimet procedurale të kërkuara prej tyre, ndërsa gjykata ka më shumë rol kontrollues dhe vlerësues të kërkesave e pretendimeve të palëve.

25. Mënyra e formulimit të nenit 61 i Kodit të Procedurës Civile ka pasur si qëllim të ruajë kontrollin e gjykatës mbi çështjen e tjera të kompetencës tokësore të ngritura nga palët pavarësisht mungesës së rolit aktiv të saj për konstatimin kryesisht të mungesës së kompetencës. Ndërkohë, interpretimi i bërë nga shumica se neni 61 i Kodit të Procedurës Civile për pjesën e kompetencës tokësore vlen edhe për gjykimet gracioze (pa palë) shuan totalisht të drejtën e gjykatës për kontrollin e kompetencës së saj tokësore në gjykimin e kësaj kategorie çështjesh pasi në këto gjykime nuk ka palë kundërshtare që mund ta ngrejë problemin e kompetencës. Për rrjedhojë zgjedhja e gjykatës nga kërkuesi në çështjet

pa palë kundërshtare me interpretimin e bërë nga shumica është shndërruar në një rregull absolut përcaktimi të gjykatës kompetente tokësore, megjithëse një gjë e tillë nuk njihet dhe as është pranuar nga ligji procedural si kriter lidhës i kompetencës.

26. Si gjyqtarë në pakicë duke mbajtur në konsideratë kushtet, që kërkon për zbatim rregulli i përgjithshëm i kundërshtimit të kompetencës tokësore të gjykatës së zgjedhur nga paditësi sipas nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësojmë se ky rregull është i zbatueshëm vetëm për çështjet me palë kundërshtare, pra paditë. Një gjë e tillë veç interpretimit gramatikor të dispozitës del dhe nga interpretimi sistematik i saj.

27. Kështu neni 61 i Kodit të Procedurës Civile është përfshirë në kreun III të Kodit të Procedurës Civile me titullin “Kompetencat”. Në germën B të këtij kreu përfshihen kriteret ligjore të përcaktimit të kompetencës tokësore, e cila vendos rregulla konkrete për përcaktimin e kompetencës tokësore në gjykimin e çështjeve me palë kundërshtare, gjë që del e qartë nga çdo rregull i vendosur në këtë krye duke filluar nga kriteri bazë i përcaktimit të saj sipas subjektit që është vendbanimi i të paditurit, në vazhdimësi me kriterin lidhës së kompetencës sipas objektit të çështjes dhe të rregulli fundor i ndryshimit të kompetencës tokësore me marrëveshje të palëve me përjashtim të rasteve të nenit 45 e 46 të Kodit të Procedurës Civile, kur ndryshimi i kompetencës me marrëveshje ndalohet me ligj. Po në pjesën C të këtij kreu përcaktohet kompetenca për shkak të lidhjes së mosmarrëveshjes. Ndërkohë neni 61 i Kodit të Procedurës Civile është përfshirë në germën D të këtij kreu, që titullohet kundërshtimi i juridiksionit dhe i kompetencës. Në unitet të të gjitha këtyre dispozitave del se kundërshtimi i kompetencës tokësore i parashikuar në nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile ka të bëjë me kompetencat e përcaktuara sipas neneve pararendëse, pra që i referohen gjykimeve me palë kundërshtare. Pra në interpretimin sistematik të vendit, që zë dispozita del se ajo përcakton mënyrën se si ngrihet e kundërshtohet kompetenca tokësore e gjykatës në çështjet pararendëse të kreut, që kanë të bëjnë përsëri me çështjen me palë kundërshtare. Në asnjë prej dispozitave të rregullimit të kompetencës të përfshira në këtë krye nuk përcaktohet kompetenca e gjykatës për shqyrtimin e çështjeve pa palë kundërshtare. Për rrjedhojë neni 61 i Kodit të Procedurës Civile nuk ka si të gjejë zbatim për çështjet me natyrë gracioze (pa palë kundërshtare), kur kompetenca e gjykatës në këto çështje nuk rregullohet nga dispozitat e kreut, ku përfshihet neni 61 i K.Pr.Civile.

28. Gjithashtu edhe neni 158/c i Kodit të Procedurës Civile, që rregullon procedurën e nxjerrjen e urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore si momentin fundor dekadent në ngritjen e çdo lloj pretendimi për moskompetencën tokësore të gjykatës është i zbatueshëm në çështjet me palë kundërshtare. Ndërkohë, në gjykimet e çështjeve pa palë kundërshtare procedura e gjykimit të tyre rregullohet në mënyrë të posaçme nga secili krye përkatës i Kodit të Procedurës Civile. Në këto krye nuk parashikohet as urdhri i kalimit në seancë dhe as ndonjë deklaratë mbrojtje nga palët e interesuara pjesëmarrëse, pasi këto të fundit nuk kanë cilësinë e palës kundërshtare. Në gjykimin gracioz palët e interesuara marrin pjesë për të ndihmuar procesin ose për shkak të pasojave, që mund të sjellë vendimi për efekte provueshmërie ndaj tyre. Në këtë lloj gjykimesh palët e interesuara nuk ngrenë pretendime ose kërtime lidhur me të drejtën që është objekt i vërtetimit të fakteve, pasi në të kundërt shqyrtimi i çështjes nga një gjykim gracioz do të shndërrohej në një gjykim kontecioz, pra me palë kundërshtare, gjë që është e papranueshme për çështjet me natyrë gracioze. Kur lind mosmarrëveshje për të drejtën objekt gjykimi në çështjet gracioze, Kodi i Procedurës Civile parashikon në nenin 391 të tij pushimin e gjykimit të çështjes, duke i dhënë mundësi palëve t’i drejtohen gjykatës sipas rregullave të përgjithshme. Ky parashikim tregon se gjykimi i padive ndryshon nga ai i çështjeve pa palë kundërshtare për të cilat Kodi i Procedurës Civile ka parashikuar dispozita të veçanta procedurale gjykimi dhe kompetence.

29. Në ndryshim nga rregullat e përgjithshme të gjykimit dhe kompetencës për çështjet me palë kundërshtare të përfshira në pikën B të kreut III, ku ndodhet edhe neni 61, për çështjet pa palë

kundërshtare Kodi i Procedurës Civile parashikon procedura të veçanta gjykimi në çdo krye përkatës sipas natyrës së çështjes, pjesë e të cilave janë dhe parashikimet e kompetencës tokësore të gjykatës për çdo rast. P.sh., neni 375 i Kodit të Procedurës Civile përcakton kompetencën e gjykatës për gjykimin e çështjes për shpalljen e vdekjes ose të zhdukjes, neni 382 përcakton kompetencën në heqjen e zotësisë për të vepruar, neni 388 kompetencën në vërtetimin gjyqësor të fakteve etj. Përcaktimi i posaçëm i kompetencës tokësore në secilën nga këto çështje pa palë kundërshtare gëzon prioritet në zbatim ashtu si dhe gjithë procedura e posaçme e gjykimit e parashikuar në kreun përkatës.

30. Dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit të Procedurës Civile do të zbatohen për gjykimet e çështjeve pa palë kundërshtare vetëm në rast se nuk parashikohet rregulla specifike në kreun përkatës të gjykimit dhe për aq sa ato janë të zbatueshme. Mbi këtë rregull gjykata është e detyruar të zbatojë në mënyrë primare këto dispozita procedurale të veçanta duke filluar së pari nga kompetenca. Përderisa në secilin nga rregullat e kompetencës për çështjet pa palë kundërshtare nuk parashikohet ndonjë rregull kufizues i mënyrës së kundërshtimit të kompetencës atëherë gjykata ka të drejtë që kryesisht të konstatojë moskompetencën tokësore të saj në gjykimin e këtyre çështjeve duke i dërguar ato pranë gjykatës kompetente. Rregulli i përgjithshëm i kundërshtimit të kompetencës nga palët në rastet e gjykimit pa palë kundërshtare i parashikuar nga neni 61 i Kodit të Procedurës Civile është i pazbatueshëm për aq kohë sa nuk ka palë kundërshtare, që mund ta ngrejë një pretendim të tillë. Përderisa ky rregull i përgjithshëm nuk mund të gjejë zbatim atëherë gjykata në këtë natyrë gjykimesh ruan të drejtë të ngrejë kryesisht kompetencën tokësore duke u udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, sipas të cilit dispozitat ligjore specifike të kompetencës tokësore janë parashikuar për t'u zbatuar dhe jo për t'u lënë pa efekt. Nëse do të pranohej mënyra e arsyetimit të shumicës se në çështjet pa palë kundërshtare gjykata nuk ka të drejtë të verifikojë kryesisht kompetencën tokësore të saj për gjykimin e çështjes atëherë të gjitha dispozitat e kompetencës tokësore të parashikuara posaçërisht për gjykimet pa palë kundërshtare do të mbeten të pazbatueshme, pasi kompetenca e gjykatës do të përcaktohej vetëm nga paraqitja e kërkesës nga pala kërkuuese.

31. Gjykatat duhet të interpretojnë dispozitat ligjore në harmoni për t'i bërë të gjitha ato të zbatueshme dhe jo për t'i lënë pa efekt sikurse ka vepruar shumica. Nëse do të kishte një qëllim të tillë ligjvënësi do e kishte bërë shprehimisht së bashku me risinë, që solli ligji nr. 38/2017 në nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile dhe për pasojë do të kishte shfuqizuar dispozitat e veçanta të kompetencës tokësore në secilën nga gjykimet pa palë kundërshtare, gjë që nuk e ka bërë. Madje as ka reflektuar ndryshimet e nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile në këto dispozita. Kjo gjendje e pandryshuar e ligjit procedural për këtë pjesë tregon se kompetenca tokësore e gjykatës për çështjet pa palë kundërshtare mbeten jashtë fushës së zbatimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile duke u ruajtur e drejta e gjykatës për të kontrolluar kompetencën tokësore për këto çështje në të njëjtën mënyrë sikurse edhe para ndryshimit të kësaj dispozite.

32. Veç sa më sipër, në bazë të interpretimit teologjik ose sipas qëllimit të ligjit , gjykata duhet të mbajë fillimisht në konsideratë se për cilën arsye parashikohen në ligj rregullat për kompetencën tokësore. Këto janë parashikuar së pari për t'u respektuar parimi kushtetues i gjykatës së caktuar me ligj në kuadër të aksesit në drejtësi dhe së dyti gjykata kompetente e njohur nga ligji prezumohet se garanton eficiencën e gjykimit të çështjes. Pra në këtë gjykatë është mundësia më e madhe të merren më lehtësisht provat dhe të zgjidhjet shpejt çështja.

33. Çështjet pa palë kundërshtare dallojnë nga ato me palë kundërshtare jo vetëm për shkak të objektit, pozitës së subjekteve procedurale në to, procedurës së gjykimit, por edhe qëllimit të realizimit të tyre. Në gjykimin gracioz ose pa palë kundërshtare gjykata nuk ka si funksion të realizojë të drejtën subjektive, por rregullimin e atyre çështjeve juridike për të cilën ligji kërkon ndërhyrjen e gjykatës. Në këtë procedurë roli i gjykatës përafron me atë të një organi administrativ, por ligji ka zgjedhur t'ia ngarkojë gjykatës për shkak të standardit më të lartë të kontrollit dhe garancive, që ofron gjykatat në zbatimin

korrekt të ligjit. Të tilla janë, p.sh., gjykimet për caktimin e kujdestarisë për të miturit e mbetur pa prindër ose pa përkujdesje, për lëshimin e autorizimit për disponimin e pasurisë së të miturve ose të personave të paaftë, për lejimin e martesës, për heqjen e zotësisë e caktimin e kujdestarit, për ndjekjen e procedurave të falimentit, i caktimit të kujdestarit të testamentit, për dhënien e pëlqimit për birësim, për zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve ku gjykata kujdeset e miraton marrëveshjen lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore etj. Po ashtu në procedurën e gjykimit gracioz dispozitat flasin për pjesëmarrësit zakonisht kërkuesi ose persona të interesuar dhe organi shtetëror, që mbart pasojat nga vërtetimi i një fakti ose lëshimi i një leje nga gjykata dhe jo paditës e i paditur sikurse ndodh në procedurës me palë kundërshtare. Në gjykimet gracioze nuk ka palë me interesa të kundërta sikurse ndodh në procedurën me palë kundërshtare. Po ashtu procedura e gjykimit të çështjeve me natyrë gracioze përbëhet nga rregulla juridike heterogjene në varësi të marrëdhënies juridike objekt i mbrojtjes ose i vërtetimit në gjykatë, të cilat dallojnë nga rregullat e përcaktuara për gjykimin me palë kundërshtare.

34. Në Kodin e Procedurës Civile janë të parashikuara procedura gjykimi të posaçme për çështjet pa palë kundërshtare të tilla si heqja e zotësisë për të vepruar, caktimi i kujdestarisë së të miturit, shpallja e zhdukjes ose e vdekjes së një personi, vërtetimi i faktit sipas nenit 388 e vijues të Kodit të Procedurës civile etj. Secila prej këtyre procedurave të posaçme të gjykimit përfshin dispozita konkrete për përcaktimin e gjykatës kompetente nga pikëpamja tokësore, që shqyrton çështjen. Në asnjë prej dispozitave të kompetencës nuk parashikohet ndonjë mundësi derogimi nga rregulli i vendosur dhe as nuk evidentohet ndonjë normë mbi mënyrën e konstatimit të mungesës së kompetencës nga gjykata. Parashikimi i rregullit të kompetencës pa asnjë mundësi derogimi në ndryshim kjo nga rregullat e përgjithshme të kompetencës, ku përfshihet neni 52 i Kodit të Procedurës Civile tregon se kompetenca tokësore e gjykatës për gjykimin e çështjes me natyrë gracioze ose pa palë kundërshtare nuk mund të ndryshohet as me marrëveshje të palëve të interesuara dhe as me zgjedhjen e gjykatës nga kërkuesi sikurse ndodh në rastin e padisë.

35. Përderisa procedura e gjykimit të çështjes me natyrë gracioze është unike për çdo rast dhe si e tillë e zbatueshme me prioritet ndaj rregullave të përgjithshme të padive, të njëjtën cilësi gëzon edhe rregulli i kompetencës së gjykatës që është pjesë e kësaj procedurale speciale. Mungesa e rregullit për mënyrën e konstatimit të kompetencës tregon se si gjykata kryesisht ashtu edhe palët kanë të drejtë të vënë në diskutim çështjen e kompetencës tokësore të gjykatës. Një interpretim i tillë del jo vetëm nga mungesa e ndalesave ose e rregullave kufizuese, por edhe nga fakti se në çështjet me natyrë gracioze është gjykata ajo, që kujdeset në mënyrë të drejtpërdrejtë për respektimin e dispozitave procedurale të posaçme të këtij lloji gjykimi, për marrjen e provave të kërkuara detyrimisht nga ligji, për njoftimin e organeve të interesuara etj., në ndryshim nga gjykimi kontecioz, ku roli i gjykatës është më pak aktiv dhe fokusohet më tepër në vlerësimin e provave të paraqitura nga palët.

36. Kriteret ligjore të përcaktimit të kompetencës mbajnë në konsideratë rregullimin e përgjithshëm të vendbanimit të të paditurit, pra të palës që paditet dhe normalisht nuk konsiderohet se është në dijeni të pretendimeve të paditësit derisa ato bëhen objekt gjykimi dhe i njoftohen nga gjykata. Më tej pala e paditur e gëzon të drejtën e saj për t'u gjykuar nga gjykata e caktuar me ligj, pasi ajo ka të drejtë të kërkojë deklarimin e moskompetencës së gjykatës sipas nenit 61/2 të Kodit të Procedurës Civile. Ndërkohë, që një garanci të tillë nuk e ka personi të drejtat e të cilit cenohen nga gjykimi ose diskutohen në çështjet pa palë kundërshtare, sikurse është i mituri, personi për të cilin kërkohet heqja e zotësisë për të vepruar, personi për të cilin kërkohet shpallja e vdekjes ose e zhdukjes etj. pasi këta persona përgjithësisht nuk marrin pjesë në proces.

37. Në çështjet me natyrë gracioze ose pa palë kundërshtare kompetenca territoriale e gjykatës përcaktohet si rregull nga vendbanimi ose vendqëndrimi i personit në interes të të cilit zhvillohet procedura gracioze pavarësisht nga fakti nëse ai merr pjesë apo jo në proces. Ky lloji gjykimi në përgjithësi udhëhiqet nga parimi i mbrojtjes së veçantë të personave të paaftë siç janë: të miturit, personat ndaj të

cilëve paraqitet kërkesë për heqje ose kufizim të zotësisë për të vepruar, personat e zhdukur ose ata të vdekur etj. Ligji i ka lënë si detyrë gjykatës të kujdeset që persona të tillë të realizojnë të drejtat që ua njeh ligji material dhe ai procedural, pasi për shkak të të metave fizike, psikike ose të mungesës ata nuk kanë mundësi të mbrojnë të drejtat e tyre. Nisur nga një rol i tillë i gjykatës, kjo e fundit ka të drejtë jo vetëm të zbatojë procedurat e posaçme, të marrë prova kryesisht, por edhe detyrimisht të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës tokësore të gjykimit të çështjes në funksion të realizimit të procedurave të rregullta gjyqësore në mbrojtje të personave në interes të të cilëve bëhet procesi, që si rregull nuk janë pjesëmarrës personalisht në proces. Garanti i mbrojtjes e i ushtrimit të të drejtave të tyre është gjykata, e cila në mbështetje të të drejtave të këtyre subjekteve mund e duhet të konstatojnë e realizojë *ex officio* çdo të drejtë procedurale, që është në interes të këtyre subjekteve, siç është edhe konstatimi e gjykimi nga gjykata kompetente e caktuar me ligj. Është kjo e fundit, që siguron jo vetëm më lehtë marrjen e provave, por për shkak të kriterit lidhës me subjektin ose objektin përmbush më mirë interesin e palëve dhe atë publik të dhënies së drejtësisë.

38. Gjithë procedura e gjykimit për çështje të kësaj natyre imponon gjykatën të mbajë në konsideratë interesat e personit, që nuk merr pjesë si palë në proces për aq kohë sa vihen në diskutim çështje, që kanë lidhje me ushtrimin e të drejtave ligjore nga këta të fundit. Mbi këtë logjikë është gjykata ajo që garanton zbatimin e ligjit procedural në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, gjë e cila fillon që me shqyrtimin e saj nga gjykata kompetente nga pikëpamja tokësore, si gjykatë e caktuar me ligj, ashtu sikurse parashikon dispozita e pjesës së posaçme të Kodit të Procedurës Civile ose e Kodit të Familjes, e ligjit “Për falimentin” etj. ku përfshihet kjo dispozitë.

39. Në kuadër të arsyetimit të vendimit, shumica ka zgjeruar zbatimin e parashikimeve të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile edhe në çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, gjë që bie po ashtu në kundërshtim me ligjin. Rregulli i përgjithshëm i parashikuar nga neni 61 i Kodit të procedurës civile që përcakton se kundërshtimi i kompetencës tokësore bëhet nga palët para se të nxirret urdhri i kalimit në seancë tregon njëkohësisht se ky rregull gjen zbatim për çështjet e shqyrtuara me seancë gjyqësore. Po ashtu shumica ka përfshirë në kategorinë e çështjeve, ku zbatohet neni 61 i Kodit të Procedurës Civile edhe kërkesat për lëshimin e urdhrave të cilat janë çështje, që i përkasin fazës së ekzekutimit, fazë kjo e cila ka një procedurë të veçantë gjykimi të dallueshme nga rregullat e përgjithshme të shqyrtimit të çështjeve me palë kundërshtare. Në këto çështje mungon si pala kundërshtare debitore, ashtu edhe shqyrtimi i saj bëhet në dhomë këshillimi. Kompetenca e shqyrtimit të çështjeve në këtë fazë i përket gjykatës së vendit të ekzekutimit.

40. Çështjet e fazës së ekzekutimit janë konsideruar me natyrë të posaçme duke u vënë theksi te prioriteti i zbatimit të dispozitave të procedurës civile të fazës së ekzekutimit për to në raport me dispozitat e përgjithshme të këtij kodi. Një qëndrim i tillë vjen nga parashikimi i nenit 203/2 të Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit nuk lejohet sigurimi i padisë për rastet e padive, që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit. Ky parashikim ndalues nuk evidenton vetëm natyrën e posaçme të masave në fazën e ekzekutimit, por rrjedh nga vetë natyra e veçantë e çështjeve të fazës së ekzekutimit të titujve ekzekutiv, e cila diferencon nga pjesa tjetër e gjykimeve me karakter të përgjithshëm. Shumica e përmend parashikimin ndalues të nenit 203 të Kodit të Procedurës Civile në kontekstin përgjithësues duke theksuar se nëse legjislatori do të kishte si qëllim të ndalonte aplikimin e një dispozite të pjesës së përgjithshme për gjykimet e posaçme do e përmendte në mënyrë të shprehur sikurse ka bërë në këtë dispozitë. Ky konkluzion i shumicës është i pabazuar, pasi së pari parashikimi i nenit 203 të Kodit të Procedurës Civile është bërë për të evidentuar diferencimin e natyrës së veçantë, që kanë masat e sigurimit të padisë në përgjithësi nga kërkesat për pezullim në fazën e ekzekutimit të udhëhequra pikërisht nga diferencat në dispozitat ligjore, që I rregullojnë ato.

41. Veç këtij rregulli bazë ligjor, gjen zbatim dhe parimi kushtetues se rregulli i posaçëm për trajtimin e një marrëdhënie ka prioritet në raport me rregullin e përgjithshëm, parim ky që vjen nga e drejta romake

se *lex specialis derogate generalis*. Një gjë e tillë gjen shprehje në një sërë ligjesh, madje edhe në ato me natyrë procedurale. Kështu, ligji 49/2012 parashikon rregullat e posaçme të gjykimit të çështjeve me natyrë administrative dhe kur ky ligj ka mungesa për rregullimin e një situatë procedurale atëherë zbatohen rregullat e përgjithshme procedurale civile për atë sa janë të përshtatshme për këtë natyrë gjykimi. Gjithashtu në çdo kapitull të gjykimeve me natyrë të posaçme siç është heqja e zotësisë për të vepruar, shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes, vërtetimi i fakteve, kundërshtimi i shitjes në ankand të sendit janë të parashikuara rregulla procedurale për mënyrën e gjykimit të tyre, dispozita këto që kanë prioritet zbatimi pikërisht për shkak se legjislatori i ka parashikuar posaçërisht për rregullimin e kësaj natyrë gjykimi. Gjithashtu edhe për kundërshtimin e vlefshmërisë së shitjes në ankand sipas nenit 580 dhe 566 të Kodit të Procedurës Civile legjislatori rishtazi ka parashikuar rregullin se ajo kundërshtohet nëpërmjet padisë së kundërshtimit të veprimeve përbarimore dhe njëkohësisht citon në mënyrë të shprehur përjashtimin se në cilat raste vlefshmëria e shitjes në ankand mund të kundërshtohet me padë sipas rregullave të përgjithshme. E njëjta gjë ndodh edhe për mbrojtjen e së drejtës së pronarit mbi sendin objekt ekzekutimi e cila realizuar sipas nenit 612 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo sipas rregullave të përgjithshme. Pra, në interpretim të këtyre dispozitave të posaçme procedurale del se rregulli bazë është se dispozita e posaçme është direkt e zbatueshme, ndërsa rregullat e përgjithshme procedurale mund të zbatohen në çështjet me natyrë të posaçme përjashtimisht vetëm nëse dispozitat e posaçme referojnë te dispozitat e përgjithshme ose kur dispozitat e posaçme nuk parashikojnë zgjidhje për situatën juridike dhe rregulli i përgjithshëm gjendet i përshtatshëm për aplikim.

42. Konkluzioni i shumicës se ligjvënësi e shmang zbatimin e një norme të përgjithshme në çështjet e posaçme nëpërmjet parashikimeve të shprehura ndaluese sikurse ka ndodhur në nenin 203 të Kodit të Procedurës Civile është i gabuar dhe për më tepër në kundërshtim me parimin e gjithëpranuar se ligji e dispozitat procedurale të posaçme për rregullimin e një natyre çështjesh kanë prioritet zbatimi në raport me rregullat e përgjithshme. Parashikimi i veçantë i nenit 203 të Kodit të Procedurës Civile përbën një rast të kufizuar të bërë nga ligjvënësi për shkak të natyrës urgjente të gjykimeve të masave të sigurimit, i cili nuk mund të përgjithësohet e për më tepër të interpretohet me analogji në gjykimin e çështjeve të themelit qoftë me palë ose pa palë kundërshtare.

43. Gjithë faza e ekzekutimit të titujve ekzekutiv ka një rregullim të posaçëm të kompetencës së gjykatës, që gjen në radhë të parë pasqyrim nga neni 516 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite i njihet e drejta përbaruesit gjyqësor të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës së tij për të vënë në zbatim, urdhrin e ekzekutimit. Përderisa një e drejtë e tillë i njihet përbaruesit gjyqësor detyrimisht e gëzon edhe gjykata që shqyrton kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Ky i fundit lëshohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit të detyrimit dhe rregullat për përcaktimin e vendit janë ato të parashikuara nga neni 516 i Kodit të Procedurës Civile. Prandaj lidhur me kompetencën e gjykatës për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit vlejnë të njëjtat rregulla si për përbaruesin gjyqësor në drejtim të konstatimit kryesisht të kompetencës.

44. Urdhri i ekzekutimit përbën një kërkesë të posaçme pa të cilin nuk mund të vihet në lëvizje gjithë procesi përbarimor i ekzekutimit të titullit. Do të ishte e pakuptimtë që palët gjatë fazës së ekzekutimit të kishin të drejtë të kontestonin kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjeve të pavlefshmërisë së titullit ose të kundërshtimit të veprimeve përbarimore etj. pra në rastet kur gjatë kësaj faze do të ngriheshin padi me palë kundërshtare dhe të mos verifikohej kompetenca tokësore kryesisht nga gjykata për nisjes e kësaj procedure, konkretisht në momentin e lëshimit të urdhrin e ekzekutimit.

45. Roli aktiv i gjykatës për konstatimin e kompetencës në fazën e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit bëhet më i nevojshëm nisur nga fakti se në nenin 35 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar për herë të parë kompetenca funksionale e gjyqtarit të fazës së ekzekutimit, parashikim, që nuk gjendet në asnjë prej rregullave të tjera të karakterit të përgjithshëm. Sipas këtij rregulli të gjitha çështjet e fazës së ekzekutimit për një titull ekzekutiv shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar. Neni 35 i Kodit të Procedurës Civile,

nenet 42 e vijues dhe nenet e fazës së ekzekutimit nuk përcaktojnë asnjë rregull se si identifikohet fillimisht gjykata funksionale e fazës së ekzekutimit. Nëse do të pranohej logjika arsyetuese e shumicës se gjykata kompetente tokësore përcaktohet nga zgjedhja e palës, që ngre padinë atëherë del se gjykata funksionale e fazës së ekzekutimit mund të jetë çdo gjykatë, ku ngrihet për herë të parë padia për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore. Një qëndrim i tillë do e bënte gjykatën e zgjedhur kompetente edhe për shqyrtimin e padisë së veçimit të pasurisë së paluajtshme pronë e debitorit, gjë që do të binte ndesh me ligjin. Për këtë lloj padie ndiqen rregullat e përgjithshme për pjesëtimin e sendeve që bëjnë kompetente gjykatën e vendndodhjes së sendeve sipas nenit 45 të Kodit të Procedurës Civile, kompetencë kjo ekskluzive, e cila mund të merret në konsideratë qoftë edhe kryesisht nga gjykata në çdo kohë sipas nenit 61/1 të Kodit të Procedurës Civile. Megjithatë, në kushtet kur kompetenca funksionale mund të ishte përcaktuar më parë atëherë përmbaruesi dhe vetë gjykata do e kishin të pamundur të zbatonin nenin 45 të Kodit të Procedurës Civile për padinë e veçimit të pjesës takuese të debitorit mbi pasuritë e paluajtshme, pasi çështja duhet të shqyrtohet nga i njëjti gjyqtar funksional i përcaktuar paraprakisht. Pra, mënyra se si interpretohet ligji nga shumica duke e shtrirë për më tepër zbatimin e nenit 61 të Kodit të Procedurës civile të kërkesat për urdhërat e ekzekutimit ose çështjet e tjera të fazës së ekzekutimit krijon premisa për përplasje e moszbatim të dispozitave ligjore qoftë edhe të kompetencës ekskluzive, që janë paraparë nga ligji si të paderogueshme.

46. Gjkata e Lartë e për më tepër kolegji njehsues ose kolegjet e bashkuara kanë si detyrë të interpretojnë normat në mënyrë të tillë që ato të jenë të zbatueshme të gjitha në harmoni me njëra-tjetrin duke evidentuar qëllimin e parashikimit të tyre dhe jo t'i lënë ato pa zbatim e për më tepër të nxisin përplasjen e normave sikurse ndodh në sajë të interpretimit që shumica i ka bërë nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile.

47. Shumica ndër të tjera analizon në vendim legjislacionin Italian sipas të cilit janë të parashikuara në mënyrë të shprehur në nenet 38, 28 e 70 të kodit të Procedurës Civile Italiane, rastet kur kompetenca tokësore është e paderogueshme duke përfshirë këtu çështjet e fazës së ekzekutimit, të heqjes së zotësisë për të vepruar etj. Kjo referencë e bërë nga shumica është e gabuar pasi në radhë të parë ky legjislacion nuk mund të barazohet me atë shqiptar. Së dyti kuptimi i kompetencës së paderogueshme në kodin e procedurës civile italiane i referohet rasteve kur kompetenca e gjykatës nuk mund të ndryshohet me marrëveshjen e palëve. Pra, Kodi i procedurës ligjore italiane ka zgjedhur të lejojë ndryshimet e kompetencës tokësore të gjykatës me marrëveshjen e palëve, mundësi që njihet edhe nga kodi ynë i procedurës civile sipas nenit 52 të kodit të Procedurës Civile.

48. Në këtë kuptim pranohet ndryshimi rishtazi i kompetencës tokësore të gjykimit të çështjes me pranimin e heshtur ose të shprehur të palës së paditur në interpretim të nenit 61/2 të kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit kur pala e paditur megjithëse ka të drejtë ta kundërshtojë kompetencën e gjykatës së zgjedhur nga paditësi nuk e bën një gjë të tillë. Përsëri edhe në këtë situatë jemi para një derogimi të pranuar nga palët dhe një gjë e tillë është e pranueshme për aq kohë sa nuk ndodhemi para kompetencës funksionale, lëndore apo asaj ekzkluzive tokësore. Në këtë situatë gjykata jokompetente e zgjedhur nga paditësi bëhet kompetente për shqyrtimin e çështjes për shkak të pranimin të shprehur ose të heshtur të palës kundërshtare, që nuk ngre pretendime për kompetencën sipas nenit 61/2 të Kodit të Procedurës Civile. Pra, qëndrimi pasiv i palës së paditur për moskundërshtimin e kompetencës së gjykatës sipas nenit 61/2 të Kodit të Procedurës civile përbën shfaqje të vullnetit të saj për të pranuar në heshtje si kompetente në gjykimin e çështjes gjykatën e zgjedhur nga paditësi, gjë që do të thotë se kemi të bëjmë rishtazi me një marrëveshje midis palëve për ndryshimin e kompetencës së gjykatës. Kjo mënyrë e ndryshimit të kompetencës së gjykatës është në përputhje me parashikimet e nenit 73, të ligjit nr. 10428, datë 2.6.2011 sipas të cilit njihet juridiksioni i gjykatave shqiptare për gjykimin e çështjeve, kur pranohet me marrëveshje të palëve ose kur i padituri merr pjesë në gjykimin e një padie të ngritur para gjykatës shqiptare pa e kundërshtuar juridiksionin megjithëse është i përfaqësuar me avokat ose nëse i është bërë

e ditur e drejta për të kundërshtuar juridiksionin dhe nuk e ka ngritur një gjë të tillë. Duke qenë se kompetenca tokësore nuk është gjë tjetër vetëm ajo pjesë e juridiksionit gjyqësor, që i është caktuar për shqyrtim një gjykate të caktuar, atëherë rregulli i parashikuar nga neni 73 ligjit nr. 10428/2011 është përfshirë në Kodin e Procedurës Civile për t'i dhënë mundësi gjykimit më të shpejtë në kohë të çështjeve me palë kundërshtare, kur pranohet kompetenca e gjykatës pa kundërshtime nga pala tjetër.

49. Ndërkohë për çështjet pa palë kundërshtare nuk mund të diskutohet derogimi i kompetencës për aq kohë sa në gjykimin e këtyre çështjeve nuk ka palë kundërshtare dhe për rrjedhojë mungon “marrëveshja” si akti procedural i derogimit të kompetencës tokësore të gjykimit të këtyre çështjeve. Zgjedhja e gjykatës nga pala kërkuuese në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk njihet si një formë e ndryshimit të kompetencës tokësore të gjykatës të parashikuar me ligj dhe as e derogimit të saj. Për rrjedhojë për aq kohë sa kompetenca tokësore e gjykatës në çështjet pa palë kundërshtare nuk afektohet nga paraqitja e kërkesës nga kërkuesi dhe nuk ka asnjë palë që mund të ngrejë pretendime për kundërshtimin e kompetencës së gjykatës së zgjedhur nga kërkuesi, atëherë është gjykata ajo që ka të drejtë të verifikojë dhe konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës si një garante e respektimit të ligjit e të procesit të rregullt ligjor, që fillon me gjykimin e çështjes nga gjykata kompetente.

50. Fakti se nuk ka ankim të veçantë ndaj vendimit të moskompetencës sipas nenit 62 të Kodit të Procedurës Civile ose se parregullsia e kompetencës është e kovalidueshme sipas nenit 467/b të Kodit të Procedurës Civile nuk i jep të drejtë gjykatës të shmangë verifikimin e zbatimin e dispozitave ligjore të kompetencës tokësore. Konvalidimi i shkeljes së dispozitave të kompetencës lejohet vetëm në rastet, kur zgjidhja e çështjes është e drejtë pra është e kushtëzuar, ndërkohë që rregulli bazë është se shkelja e dispozitave të kompetencës përbën shkak për prishjen e vendimin e dërgimin e çështjes për rigjykim sipas nenit 467/a të Kodit të Procedurës Civile. Në rastet e shkeljes të dispozitave të kompetencës i vetmi vendim që kovalidon këtë shkelje është vendimi i lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që gjykata e Apelit është e kufizuar të marrë çdo vendim tjetër të ndryshëm të përcaktuar në nenin 451 të Kodit të Procedurës Civile. Kështu, që kovalidimi i kufizuar i shkeljes së kompetencës nuk mund të përbëjë një argument, që lejon shkeljet e dispozitave të kompetencës tokësore dhe për më tepër të çojë në shmangien totale të zbatimit të tyre në rastet e çështjeve pa palë kundërshtare sikurse konkludon shumica.

51. Mënyra e interpretimit të nenit 61 të Kodit të Procedurës Civile nga shumica duke e shtrirë zbatimin e tij dhe në çështjen pa palë kundërshtare jo vetëm, që bie ndesh me frymën e kësaj dispozite dhe të dispozitave procedurale të veçanta për kompetencën tokësore, por krijojnë premisa për abuzime me të drejtën e ngritjes së kërkesave në çështjet pa palë kundërshtare. Kështu, në këto çështje merr pjesë vetëm pala, që ka interes për gjykimin dhe jo subjekti tjetër të drejtat e të cilit diskutohen në çështje. Kjo i jep mundësi palës kërkuuese që të ngrejë për disa herë dhe para gjykatave të ndryshme të njëjtën kërkesë megjithëse ajo mund të jetë rrëzuar nga një gjykatë e mëparshme. Pra, ndalimi i së drejtës së gjykatës për të kontrolluar kryesisht kompetencën e gjykimit të çështjeve pa palë kundërshtare sikurse u interpretua nga shumica do të krijojë kushte për shmangien e kontrollit të institutit të gjësë së gjykuar në çështjet e kësaj natyre duke u rritur rastet e abuzimit me të drejtën nga palët kërkuuese. Këto të fundit aktualisht do të kenë mundësi të paraqesin të njëjtën çështje në gjykate të ndryshme për disa herë derisa sa të sigurojnë një vendimmarrje pozitive, në interes të tyre megjithëse kërkesa mund të jetë rrëzuar nga një gjykatë tjetër. Konstatimi kryesisht i mungesës së kompetencës tokësore nga gjykata e dërgimi i çështjes për kompetencë shqyrtimi në të njëjtën gjykatë të përcaktuar nga ligji, siguron mundësi më të lartë kontrolli dhe kufizim të abuzimit me të drejtën e ngritjes së kërkesës së përsëritur, për shkak të sistemeve të menaxhimit kompjuterit, që funksionojnë në çdo gjykatë.

52. Në çështjet pa palë kundërshtare garanti i kontrollit të ligjshmërisë së kërkesës është vetëm gjykata dhe roli i saj nuk mund të kufizohet qoftë edhe në pjesën e kompetencës tokësore përderisa një gjë e tillë nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur në dispozitat procedurale të posaçme, që rregullojnë këtë

natyrë gjykimesh. Për më tepër çështjen pa palë kundërshtare janë parashikuar jo vetëm në Kodin e Procedurës civile, por edhe në një sërë ligjesh apo kodesh të tjera si Kodi i Familjes, dispozita këto që gëzojnë prioritet në zbatim për shkak të veçantisë së tyre, që është e lidhur jo vetëm me aspektin procedural të mjetit që vë në lëvizje gjykatën, natyrën e gjykimit por me objektin e çështjes duke përmbajtur në këto kushte element të lëndës siç ndodh për çështjet e natyrës familjare ose të asaj tregtare, të falimentit etj. Në kontekstin historik të zhvillimit të legjislacionit procedural, Kodi i Procedurës Civile ka parashikuar jo vetëm seksionin administrative, por edhe atë familjar e tregtar të gjykatave. Lënda e mosmarrëveshjes sipas këtyre kategorive përcaktonte dhe seksionin përkatës që shqyrtonte çështjen. Aktualisht sipas nenit 320 të Kodit të Procedurës Civile vazhdon të ekzistojnë seksione familjar dhe tregtar, ndërsa seksioni administrative nuk ekziston pasi është krijuar gjykata administrative. Janë pikërisht këto seksione, që kanë në kompetencë lëndore shqyrtimin e mosmarrëveshjeve familjare ose tregtare. Këto parashikime tregojnë se në çështjet e kësaj natyre ndërthuren jo vetëm element të kompetencës tokësore, por edhe ato të kompetencës lëndore. Lidhur me këtë të fundit neni 61/1 i Kodit të Procedurës Civile lejon gjykatën të ngrejë kryesisht çështje të kompetencës. Në këto kushte roli aktiv i gjykatës në ngritjen e çështjes së kompetencës tokësore për çështjet me natyrë familjare e tregtare është i padiskutueshëm për atë kohë sa seksionit përkatës së gjykatës kompetente nga pikëpamja tokësore i përket kompetenca lëndore e shqyrtimit të çështjes konkrete.

53. Për sa më sipër në unitet të të gjitha argumenteve të sipërcituara gjyqtarët në pakicë kanë votuar që sentenca njehsuese duhet të ishte si më poshtë;

- Në çështjet pa palë kundërshtare gjykata ka të drejtë të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës tokësore të saj duke i dërguar aktet në gjykatën kompetente të caktuar nga ligji.

II. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

54. Në çështjen konkrete, rezulton se kompetenca tokësore për lëshimin e autorizimit për shitje të pasurisë së të miturit i përket gjykatës së vendbanimit të të miturit. Duke qenë se kjo kompetencë territorial rregullohet në mënyrë të posaçme nga ligji dhe çështja është pa palë kundërshtare, gjykata si garante e respektimit dhe e mbrojtjes së të drejtave të palëve në interes të të cilit zhvillohet gjykimi, pra të miturit, ka të drejtë të konstatojë kryesisht mungesën e kompetencës së saj për gjykimin e çështjes.

55. Për rrjedhojë vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila ka konstatuar kryesisht mungesën e kompetencës tokësore për shqyrtimin e kërkesës së kërkuarve është marrë në përputhje me rregullat procedurale të natyrës së gjykimit të çështjes. Gjykata kompetente në këtë rast është caktuar nga neni 234 i Kodit të Familjes, pra jo vetëm nga një dispozitë procedurale e posaçme, por edhe nga një Kod i posaçëm për e të drejtave dhe procedurave të gjykimit të mosmarrëveshjeve familjare. Sipas nenit 2 të Kodit të Familjes parashikohet, se: *Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.* Ndërsa në nenin 54 të Kushtetutës parashikohet se *Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.* Këto dispozita vënë theksin në rëndësinë e mbrojtjes së interesit të të miturit, i cili rëndon para së gjithash mbi organet shtetërore e gjykatat.

56. Një detyrë e tillë i ngarkon gjykatat me përgjegjësi për të verifikuar e vlerësuar interesat e të miturve pa e lidhur atë me interesat e prindërve ose të kujdestarëve, që përgjithësisht janë subjektet procedurale, që vënë në lëvizje gjykatën si kërkuar, për njohjen e një të drejte ose lëshimin e një autorizimi, që ka të bëjë me të miturin ose me administrimin e pasurisë së tij. Duke qenë se interesi i të miturit qëndron mbi atë të subjektit kërkuar, që vë në lëvizje gjykatën, atëherë është kjo e fundit e cila kontrollon dhe përfaqëson interesat e të miturve në proces. Për atë kohë sa është ngarkuar me një përgjegjësi të tillë nga ligji, gjykata ka të drejtë që në mbrojtje të interesave të të miturit të zbatojë *ex officio* çdo dispozitë procedurale në interes të një procesi të rregullt ligjor në interes të të miturit dhe jo të palës kërkuar.

57. Për rrjedhojë në rastet e administrimit të pasurisë së të miturit gjykata kompetente është përcaktuar ajo e vendbanimit të të miturit, pasi është kjo gjykatë që në vazhdimësi kontrollon dhe krijon precedent në vlerësimin e interesave të të miturit, dhe e ka më të lehtë administrimin e provave nga organet kompetente në këtë fushë. Përcaktimi i kësaj gjykate kompetente për gjykimin e çështjes është në përputhje me Konventën e Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, që përcakton në nenin 5 të tij se *Autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit kontraktues, ku fëmija ka banesën e përbërshme, kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës ose të pronës së tij*. Gjkata kompetente tokësore për çështjet e administrimit të pasurisë së të miturit konsiderohet ajo e vendbanimit të tij, e cila është përgjegjëse për ndjekjen në dinamikë të ecurisë dhe administrimit të pasurisë së të miturit dhe si e tillë është ajo që garanton më mirë interesat e tij. Nga ky rregull i kompetencës nuk lejohet shmangie. Subjektet kërkuese nuk kanë të drejtë të zgjedhin e të përcaktojnë “vetë” nëpërmjet paraqitjes së kërkesës një gjykatë tjetër si kompetente për gjykimin e çështjeve, të ndryshme nga ajo e parashikuar nga ligji.

58. Pranimi i përcaktimit të kompetencës tokësore të gjykatës nëpërmjet paraqitjes së kërkesës nga kërkuesi jo vetëm do të vinte ndesh me kompetencën tokësore të përcaktuar në ligj, por do e vinte gjykatën në pamundësi për të zbatuar dispozitën ligjore të kompetencës, pasi i mituri nuk është i përfaqësuar si palë më vete në këtë proces dhe interesat e tij mbrohen vetëm nga gjykata. Për rrjedhojë dispozita procedurale e kompetencës do të ishte e pamundur të zbatohet në kundërshtim me detyrimet kushtetuese dhe konvatore të gjykatës e të shtetit të marra përsipër në çështjet me të mitur.

59. Në rezyme të sa më sipër ne gjyqtarët në pakicë vlerësojnë me vendimi nr. 5063, datë 11.10.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me të cilin është vendosur shpallja e moskompetencës tokësore dhe dërgimi i çështjes pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është i bazuar në ligjin procedural dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

**Për sa më sipër,
Në bazë të nenit 308/1 të K.Pr.Civile**

Mendimi i gjyqtarëve në pakicë për zgjidhjen e çështjes është;

Lënien në fuqi të vendimit nr. 5063, datë 11.10.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjyqtar: Sokol Ngresi
Gjyqtare/relatore: Margarita Buhali